



Informacion të nderveprimit në Mjedis

Projekti

Ndërtim i Linjës Ajrore 220 (400) kV Tirana2 - Rrashbull,

Zgjerim dhe përforcim i N/stacionit Tirana2 dhe N/stacionit Rrashbull,

Ndërtim i linjave të reja të transmetimit 110 kV (Tirana 1 - Traktori - Tirana3, Tirana3 - Selita dhe Tirana3 - Farka)

Ndërtim i N/stacionit të ri 400/110 kV Tirana3



Autorë:

| | | | |
|-----------|-----------|------|----------------------------|
| Prof.asc. | Sazan | GURI | (Ekspert Mjedisi) |
| M. Sc. | Marianthi | GURI | (Ekspert gjeo-mjedisi) |
| M. Sc. | Denisa | BALO | (Ekspert Shendetit Publik) |

Tiranë – Prill 2017

PËRMBAJTJA

II. Informacion i nerveprimit

2.1 PËRSHKRIMI I MBULESËS BIMORE

2.2 INFORMACION PËR PRANINË E BURIMEVE UJORE

2.3 INFORMACION PER IDENTIFIKIMIN E NDIKIMEVE TË MUNDSHME

2.3.1 Ndikimi negativ në mjedis

2.3.2 Ndikimet në biodiversitet

2.3.3 Ndikimet në ujë

2.3.4 Ndikimet në tokë

2.3.5 Ndikimet në ajër

2.4 SHKARKIMET E MUNDSHME NË MJEDIS

2.4.1 Shkarkimet e ujërave të ndotura

2.4.2 Gazet

2.4.3 Pluhërat

2.4.4 Zhurmat

2.4.5 Vibrimet

2.4.6 Prodhimet e mbetjeve

2.5 INFORMACION PËR KOHËZGJATJEN E NDIKIMEVE NEGATIVE

2.6 TË DHËNA PËR SHTRIRJEN E HAPËSINORE TË NDIKIMIT NEGATIV

2.6.1 Distancën fizike nga vendndodhja e projektit

2.6.2 Vlerat e ndikuara

2.7 MUNDËSINË E REHABILITIMIT TË MJEDISIT TË NDIKUAR

2.7.1 Mundësinë e kthimit të mjedisit të ndikuar në gjëndjen e mëparshme

2.7.2 Kostot financiare të përafërta për rehabilitim

2.8 MASAT E MUNDSHME PËR SHMANGIEN

2.8.1 Zbutjen e ndikimeve negative në mjedis

2.9 NDIKIMET E MUNDSHME NË MJEDISIN NDËRKUFITAR

III. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

3.1 PËRFUNDIME

3.2 REKOMANDIME

IV. STUDIME MBËSHTETËSE

HYRJE

Procesi i vlerësimit të ndikimit në mjedis bazohet në Legjislacionin Shqiptar dhe atë ndërkombëtar. Procesi i vlerësimit të ndikimit në mjedis siguron një përmbledhje të informacionit të disponueshëm në përputhje me kushtet e vend-ndodhjes së veprës, duke përfshirë kushtet fizike dhe atmosferike, burimet ujorë dhe biologjikë, kulturën dhe kushtet social-ekonomike të zonës. Metoda e përshtatshme për vlerësimin e ndikimit në mjedis është ajo e list-kontrollit, e cila vendos nga njëra anë të gjitha burimet e mundëshme të ndikimeve dhe nga ana tjetër bartësit e ndikimeve, si dhe parashikimin e madhësisë së ndikimit. Madhësia e ndikimit është shprehur me një sistem prej 5 shkallësh (+) dhe (-). Në këtë studim jepen në detaje:

- Mundësitë për teknologji të pastër;
- Rritje dhe zhvillim të qendrueshëm;
- Shqyrtimi i alternativave të ndryshme brenda projektit.
- Vlerësimi cilësor me pike të ndikimeve në mjedis të projektit.
- Propozimeve të masave zbutëse të ndikimit të projektit.

Ndotja e ajrit nga ky aktiviteti përfshin kryesisht atë të zonës brenda saj, të cilat do emetohen në sasi të papërfillshme. Ndotja e ajrit do të jetë në nivele të kontrolluara.

Kërkesat e procesit të vlerësimit të mjedisit

Procesi i vlerësimit të ndikimit në mjedis, paraqet masa lehtësuese për të minimizuar ose për të ndaluar ndikimet sociale dhe mjedisore të projektit. Këto përfshihen në një Plan Menaxhimi Ambiental (PMA), i cili mund të shihet i detajuar në raport. PMA konsiston në vendosjen e masave lehtësuese, monitoruese dhe institucionale, që do të ndërmerren gjatë ndërtimit dhe operimit për të eliminuar, kompesuar ose për të zvogëluar ndikimet ambientale dhe sociale. Plani, gjithashtu përfshin veprimet, që nevojiten për të zbatuar këto masa. Procesi i vlerësimit të ndikimit në mjedis përcakton menaxhimin specifik mjedisor e planet monitorues dhe identifikon të gjitha nevojat e raportuara, si dhe afatet.

Â Vlerësimi i ndikimeve potenciale

Pas identifikimit duhet të parashikohet madhësia dhe natyra e ndikimit në mjedis. Parashikimet bëhen mbi ndryshimet potenciale në çdo parametër mjedisor, si në shmangien e ndotjes së ajrit, zhurmave dhe cilësisë së ujrave.

Â Vlerësimi i ndikimeve reale

Ndikimet reale mund të përcaktohen, duke vlerësuar po këto ndikime ndaj:

- standarteve mjedisore;
- rregullores së shfrytëzimit të tokës;
- preferencave të publikut dhe oponencave të specialistëve;

Â Identifikimi i masave zbutëse

Kur një ndikim vlerësohet si i papranueshëm, atëherë kërkon mjete dhe masa zbutëse dhe mbrojtëse, që përfshijnë ndryshimin e metodave dhe parashikim masash lidhur me kohën e zbatimit, mënyrën dhe mjetet që do të përdoren si:

- Kompesim për burime apo sipërfaqe të dëmtuar;
- Vëzhgim i zbatimit të masave zbutëse;

Â Vlerësimi i shumëllojshmërisë së gjallesave, florës dhe faunës

- Konventa e Diversitetit Biologjik përkufizon shumëllojshmërinë e gjallesave si: “Llojshmërinë e organizmave të gjalla dhe komplekset të cilat ato u përkasin. Kjo përfshin ndryshueshmërinë brenda specieve dhe të vetë ekosistemeve”. Matësit e shumëllojshmërisë së gjallesave përfshijnë elementë si ndryshueshmërinë gjenetike brenda specieve, etj.

Ë Identifikimi i ndikimit dhe lehtësimet e propozuara

- Ndikimet e mundshëm pozitivë dhe negativë të projektit të propozuar janë identifikuar dhe matur në masën më të konsiderueshme të mundur. Kapitulli, gjithashtu përfshin informacion mbi masat lehtësuese, që duhen marrë për pakësimin e ndikimeve negative, gjatë menaxhimit të mbetjeve Aksi Iore, si dhe mbi ndonjë ndikim negativ të mbetur, që nuk mund të lehtësohet. Gjithashtu, ky kapitull identifikon dhe vlerëson shtrirjen dhe cilësinë e të dhënave në dispozicion, të dhënat kryesore për boshllëqet, si edhe paqartësitë e shoqëruara me parashikime.

Identifikimi i ndikimit dhe lehtësimet e propozuar

Ndikimet e mundshëm pozitivë dhe negativë të projektit të propozuar janë identifikuar dhe do të maten në masën më të konsiderueshme të mundur. Gjithashtu, në këtë raport përfshihen informacione mbi masat lehtësuese, që duhen marrë për pakësimin e ndikimeve negative, gjatë ndërtimit të Linjës Ajrore 220 (400) kV Tirana 2 - Rrashbull, zgjerimi dhe përforsimi i nënstacionit Tirana 2 dhe nënstacionit Rrashbull, ndërtimi i linjave të reja të transmetimit 110 kV (Tirana 1 - Traktori - Tirana 3, Tirana 3 - Selita dhe Tirana 3 - Farka) dhe ndërtimi i nënstacionit të ri 400/110 kV Tirana 3, si dhe mbi ndonjë ndikim negativ të mbetur, që mund të lehtësohet.



II. RAPORTI PARAPRAK I VNM-së

2.1. PROCESI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT

Qëllimi i VNM, është të sigurojmë informimin për një mjedis të pastër dhe të shëndetshëm dhe ndërgjegjësimin e publikut, që nëpërmjet vlerësimit cilësor e sasior paraparak të parametrave ekologjik, të treguesve morfologjik e gjeomorfologjik, hidrogeologjikë e hidrologjikë, të kushteve gjeologjiko-inxhinierike (vetitë fiziko-mekanike), parametrave sizmo-tektonik, të bazuara në kriteret standarte shkencore ndërkombëtare, sipas Konventave Ndërkombëtare e Kombëtare, të tipizohen dhe të përzgjidhen një sërë parametrash dhe veçorish të sistemeve natyrorë, në shërbim të menaxhimit të infrastrukturës mjedisore, të mbrojtjes së aksidenteve, të përmirësimit të kushteve të punës të ndërtimit të *Linjës Ajrore 220 (400) kV Tirana 2 - Rrashbull, zgjerimi dhe përforcimi i nënstationit Tirana 2 dhe nënstationit Rrashbull, ndërtimi i linjave të reja të transmetimit 110 kV (Tirana 1 - Traktori - Tirana 3, Tirana 3 - Selita dhe Tirana 3 - Farka) dhe ndërtimi i nënstationit të ri 400/110 kV Tirana 3,, me objekt Rritjen e kapacitetit të transmetimit në Shqipëri e veçanti në zonën urbane të Tiranës dhe Rrashbull. Ky raport vlerësimi ka për qëllim:*

- Paraqitjen e gjendjes reale e ndikimit të këtij aktiviteti, mbi mjedisin natyror dhe human;
- analizimin e faktorëve pozitivë e negativë mjedisore;
- dhënien e masave zbutëse për zvogëlimin e ndikimeve negative;
- planin e menaxhimit lokal dhe monitorimet për zërat përkatëse.

si dhe tenton për përmirësimin e vlerave ekologjike e rikrijuese të territorit pas ndikimit të mundshëm në mjedis. Ndërtimi i këtyre linjave, ndërmerret si një iniciativë, që do të tentojë, përveç sigurimit të Përmirësimit të Rrjetit transmetimit në zonën urbane Tiranë, por edhe në;

- Shfrytëzimin dhe përdorimin e energjisë elektrike në vend.
- Përmirësimin e sistemit të transmetimit në nivelet kombëtar sipas standarteve dhe parametrave bashkëkohor;
- Rritjen e nivelit të tensionit në konsumator;
- Sigurimin e vazhdueshmerisë së furnizimit me energji elektrike të konsumatoreve;
- Përmirësime me qëllim perballimin e ngarkesave të energjisë elektrike,;
- Zbatimin e kërkesave për normalizimin e ngarkesës në sistemin e furnizimit me energji elektrike në këto zone, si dhe për të përmirësuar furnizimin me energji elektrike me cilësi dhe standart evropian, në mënyrë që ai të shërbejë realisht për një aktivitet të qëndrueshëm;
- Zbatimin e rregullores së sigurimit teknik.
- Ruajtjen e vlerave ekologjike të peizazhit;
- Rritjen e punësimeve në këto zona.
- Përmirësimin e jetesës së komunitetit të zonës.
- Rritjen e mundësisë për të përdorur shërbimet në investime mbi menaxhimin e mirëmbajtjen e tyre.

2.1.2. Metodika

Studimi i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis u orientua nga madhësia e projektit, vendi ku ai ndodhet, pasuritë natyrore dhe humane të zonës, si dhe vlerat e veçanta të tyre, identifikimi i ndikimeve negative dhe pozitive, marrja e masave zbutëse, duke patur parasysh edhe ruajtjen e interesave ekonomike të investitorit dhe masat orientuese për një zhvillim të qëndrueshëm të projektit. Në këtë studim identifikohen ndikimet pozitive dhe negative në natyrë dhe në mjediset humane, si dhe është marrë parasysh dhe vlerësimi i rrezikut. Reduktimi i ndikimeve negative

është ndërthurur edhe me ndikime të rëndësishme pozitive, sidomos në kompesime indirekte mbi komunitetin. Studimi është kryer duke u ndarë në fazat kryesore si:

1. Ngritja e objektivave orientuese të projekt-studimit;
2. Mbledhja e materialit bazë ekzistues dhe atij të formuluar enkas për këtë projekt dhe seleksionimi i saj për përdorim;
3. Verifikimi në terren i të dhënave ekzistuese dhe mbledhja e të dhënave të mundshme biofizike dhe humane;
4. Hartimi i projektit dhe dorëzimi tek porositësi, si dhe tek subjektet vendim-marrëse dhe kontrolluese të aspekteve mjedisore, në nivele qendrore dhe lokale;

Metodologjia e përdorur

Për realizimin e studimit të VNM-së u kryen:

a. Vrojtme në terren në rajon të gjerë, duke kryer vrojtme pedologjike, gjeomorfologjike, ekologjike, si edhe hidrologjike, të shumëllojshmërisë së gjallesave, si dhe të përdorimit të tokës. Për të realizuar objektivat e këtij studimi janë marë:

- foto në territorin në studim;
- takime me ekspertët lokal dhe komunitetin e zonës;
- takime me specialistë të OST-së;

b. Argumentimi i bazuar mbi vlerësimin e:

- Studimi dhe skema e zhvillimit teknologjik;
- inventaret e të dhënave ekzistuese;
- informacionet bazë, në botimet periodike mbi këtë zonë;
- Pajtueshmëria me kërkesat ligjore si cilësia e ajrit, shkarkimet ujore, niveli i zhurmave dhe mbetjet inerte.

c. Vlerësimin me metodën e listë-kontrollit, e cila vendos nga njëra anë të gjitha burimet e mundshme të ndikimeve dhe nga ana tjetër bartësit e ndikimeve, si dhe parashikimin e madhësisë së ndikimit. Madhësia e ndikimit është shprehur me sistem prej 5 shkallësh (+) dhe (-). Burimet kryesore, për punimet e ndertimit të këtyre linjave, me objekt Rritjen e kapacitetit të transmetimit në Shqipëri e veçanti në zonën urbane të Tiranës dhe Rrashbull janë:

- Mbajtja pastër e mjedisit përreth dhe në standarde të kënaqshme, pa shkaktuar mbetje ose ndotje, për të ruajtur kushtet ekologjike të zonës;
- përdorimi i rrjetave për izolimin e pluhurave dhe shmangien e aksidenteve;
- sperkatjen me ujë gjatë punimeve të gërmimit dhe montimit të linjës;
- Mbrojtja e kushteve ekologjike sipas standardeve;

Nga Institucionet e specializuara, sipas porosisë së AKM/MM mund të kryhen monitorimet si më poshtë:

- Monitorimi i ajrit, nuk ka nevojë të kryhet
- Përsa i përket zhurmave, frekuencat e monitorimit do të përcaktohen nga specialistët e kësaj fushe pranë inspektoriateve përkatëse

Shoqëria investuese do të mirëpresë, ndihmojë dhe lehtësojë, çdo iniciativë vëzhguese mjedisore, që do të këshillohet në "lejen mjedisore", në shërbim të së cilës është kryer edhe ky studim.

2.2. PËRSHKRIMI I MBULESËS BIMORE

2.2.1. Veçoritë fizike të Rajonit

Gjeografikisht zona në studim ndodhet në fushën e depresionit të Tiranës dhe bënë pjesë në njësinë fiziko gjeografike Ultësira Përendimore. Ky territor ka një ekspozim në drejtimin verior, pra një ekspozim gjysëm të hapur. Lartësia mestare e territorit është 125m mbi nivelin e detit.

A) Bota bimore e zonës së Bashkisë Tiranë

Kushtet klimatike mesdhetare dhe kushtet e veçanta ujore të këtij ekosistemi kanë përcaktuar një mbulesë bimore dhe një botë shtazore të larmishme. Bimësia dallohet për periudhën e gjatë të vegjetacionit mbi 10 muaj. Bimësia e pllajës përbëhet kryesisht nga dushqet dhe fiernat më pak nga shkurret mesdhetare dhe ahishtet në pjesët më të larta të saj. Në brezin e dushkut mbizotëron qarri, me nënpyll shkurret e shkozës, lajthisë, dëllinjës dhe shpesh të bushit. Shkurret mesdhetare në drejtim të lindjes bëhen më të rralla, ndërsa bimët me gjelbërim të përherëshëm zëvendësohen nga ato që i rrëzojnë gjethet. Përfaqësuesit kryesorë janë mareja, shqopa, driza, dëllinja, etj. Ahishtet në shumicën e rasteve janë të pastra dhe të zhvilluara mirë, kurse në shpatet e pjerrëta dhe me orientim nga jugu e perëndimi shoqërohen me halorë ose edhe me fletorë të tjerë (kryesisht panjë).

Fauna e zonës

Nga çpyllëzimi, flora dhe fauna janë ekspozuar ndaj fenomenit antropogjen, duke vënë në kërcënim zhdukjen e habitateve të krijuara ndoshta 100-ra vjeçare. Llojet kryesore këtu janë lepuri, dhelpra, çakalli, qelbsi, nuse lalen, etj. Sensibilizimi i komuniteti për ruajtjen e florës dhe faunës nuk është në nivele të dëshiruara, dhe si rrjedhojë ndodhin fenomene që çojnë në prishjen e ekuilibrave mjedisore. Nga gjitarët e tjerë të lidhur me pyjet fletore janë ketri, kunadhja, macja e egër etj. Nga shpendët rriten harabelat, gardalinat, trishtilat, qukapikët, grifshat, gushëkuqi, mëllenja etj.

B) Biodiversiteti, fauna dhe flora e bashkisë Durrës.

Durrësi karakterizohet nga biodiversiteti tipik i një zone mesdhetare. Habitatet shtrihen nga kodrat dhe fushat rreth qytetit. Ndër llojet kryesore dhe më të përhapura të florës drusore mund të përmendim: Pishat bregdetare (*Pinus* spp), Shqopën (*Erica* spp), Dëllinjën (*Juniperus* spp) Gjineshtren (*Spartium junceum*), Plepat (*Populus* spp), Shelgun (*salix* spp), Selvinë (*Cupressus* spp), Trëndafilin e egër (*Rosa canina*). Në zona të caktuara dallohet edhe Ulliri (*Olea* spp) dhe shkurret e gjelbërta si: *Forsythia europa*, *Rubus fruticosus*. Shkurrja *Forsythia Europa* është një bimë endemike shqiptare. Flora barishtore nga ana e saj përfaqësohet më lloje të familjeve Graminacea, Leguminacea si dhe ato mjekësore nga të cilat mund të përmendim: *Festuca* sp, *Trifolium*, *Vicia* spp, *Urtica dioica*, *Sanguisorba officinalis*, *Salvia* sp, *Melisa officinalis*, Lulëkuqja (*Papaver rhoeas*), Bari i bletës (*Melisa officinalis*) Çikorja (*Cichorium intybus*). Bimësia e zonës më të ulët karakterizohet përgjithësisht nga prania e florës që normalist rritet në tokë moçalore të kripur, siç janë *Juncus acutus*, *Salicornia europea*, *Limonium vulgare*, *Hardeummarinum* dhe *Halimione portulacoides*, ndërsa toka me bar karakterizohet përgjithësisht nga *Dittrichia viscosa*, *Scalymus hispanicus*, *Pheniculavulgaris*, *Daucus carata*, *Eryngium* spp., *Linaria* spp., *Trifolium campestre*,

Avena sterilis, Hardeum murinum, Cynosurus echinatus, Achantus spp., Pteridium aquilinum, Rubus hulmifolius.

Fauna tokësore

Pakësimi i hapësirave të gjelbra dhe eliminimi i gradual kryesisht i pishave në zonën e bregdetit por edhe në kodrat e qytetit ka bërë që të pakësohen habitatet për shpendët e për pasojë edhe shpendët. Shtimi i kurorave të gjelbërta do të ndihmonte shumë në ruajtjen dhe shtimin e fondit të shpendëve në zonë. Avifauna përfaqësohet nga zogj si; harabelat (fam. Passeridae), Korbi (fam. Corvidae), Gushkuqi evropian (fam. Muscicapidae), Gardalina, Carduelis carduelis (fam. Fringillidae); Pëllumbat, Columba palumbus dhe Columbia civia (fam. Columbidae). Nuk ka të dhëna për numrin dhe shpërndarjen e tyre. Pjesa e faunës tokësore përfaqësohet me kafshë si; Canis aureus (fam. Canidae), lepuri i egër, Oryctolagus cuniculus (fam. Leporidae) si dhe nga disa kafshë shtëpiake lopë, derra, dele, dhi etj. Gjithashtu gjenden edhe insekte si Gryllotalpa gryllotalpa, Agrotis segetum, Melolontha melolontha, Leptinotarsa decemlineata etj. Amfibët dhe zvarranikët janë të shumtë dhe mund të përmendin bretkocën Rana dalmatica, gjarprin Vipera ammodytes, zhapinjët Lacerta spp. etj. Disa nga kafshët e sipërpërmendura janë seriozisht të rrezikuara si pasojë e presioneve të mëdha të zhvillimit në zonat e sipërpërmendura.

2.2.2. Sistemi sizmologjik

Sipas "Studimit të Rajonizimit të Shqipërisë sipas Termeteve" të kryera nga Akademia e Shkencave si dhe duke ditur që Shqipëria bën pjesë në rrypin bregdetar të Mesdheut Lindor që fillon nga Shqipëria Veriore deri në Greqinë Jugore dhe njihet si zonë me sizmicitet të lartë që kap vlerat deri në 8 balle, edhe kjo zonë, si pjesë e këtij rajoni i nënshtrihet teknikave dhe kushteve ndërtimore të tilla për të përballuar këto forca natyrore. Nga pikëpamja sizmotektonike, zona mund të goditet në të ardhmen nga tërmete me magnitudë $M_{max} = 5.5-5.9$ gradë Richter, ndërsa sipas hartës së tërmeteve maksimale të mundshëm, qyteti i Tiranës përfshihet në zonën me $M_{max} = 5.8-6.4$. Mbështetur në hartat e rrezikut sizmik, në formë probabilitare, qyteti i Tiranës dhe rrethinat e tij përfshihen në zonën ku, lëkundjet e truallit me intensitet $I_0=8$ ballë ($PGA = 0.2 g$) ndodhin çdo 200-250 vjet. Nga ky këndvështrim, për të shmangur rreziqet nga tërmetet, del për detyrë të studiohen:

- Dukuritë e lëngëzimit të rërave, të vrojtuar nga tërmetet e së kaluarës;
- Tërmete me intensitet maksimal të mundshëm;
- Vetive fiziko mekanike të rërave;
- Vlerësimi të potencialit të lëngëzimit të rërave të zonës.

Ndër treguesit e pafavorshëm gjeoteknik, më kryesoret janë:

- Sizmiciteti i lartë (Magnitude VIII - IX, sipas shkallës Rihter);
- Lëngëzim i paneglizhueshem i rërave;
- Sipërfaqja e tokës në studim janë të qëndrueshme ndaj erozionit, për shkak të mospjerrësisë së saj, megjithë pranisë së rrjedhave ujore sipërfaqesore

Veprimtaria sizmike

Nga zona e shkëputjeve aktive të Tiranës janë gjeneruar shumë tërmete, ndër më të fuqishmit janë: tërmeti i vitit 1617 me $I_0 = 8$ ballë (MSK-64) në Krujë; tërmeti i 26.08.1852 me $I_0 = 8$ ballë (MSK-64) në Kepin e Rodonit; tërmeti i 13.05.1860, me $I_0 = 8$ ballë (MSK-64) në Urën e Beshirit; tërmeti i 04.02.1934 me $M = 5.6$ dhe $I_0 = 7$ ballë (MSK-64) në Zonën e Vrapit; tërmeti i 16.09.1975 me $M = 5.3$

në Kepin e Rodonit; tërmeti i 22.11.1985 me $M = 5.5$ në gjirin e Drinit; tërmeti i 09.01.1988 me $M = 5.7$ në Tiranë.

Karakteristikat sizmotektonike të zonës

Tërmeti më i fortë që ka goditur Tiranën është ai i datës 09.01.1988, me $M = 5.7$ (ISC) dhe intensitet $I_0 = 7-8$ balle (MSK-1964). Nxitimi maksimal arriti $PGA=0.4g$ në komponenten L-P, $PGA = 0.1 g$, në komponenten V-J dhe $PGA = 0.07 g$ në komponenten vertikale Z ndërkohë që kohëzgjatja e tij nuk i kaloi 6 sekondat.

2.2.3. Kushtet gjeologjike

Nga pikëpamja tektonike kemi të bëjmë me depresionin e Tiranës, që përbën një element të madh strukturor në zonën Jonike, që preket nga forcat tektonike orogjenike. Shkëputjet tektonike janë shume aktive, dhe në reliev shprehen me kontraste të theksuara të tij (Monoklinali i Prezës). Si pjesë përbërëse e një strukture neogenike në zhvillim, zona në studim preket nga forcat tektonike orogjenike dhe sidomos nga ato neotektonike. Zona e studimit ndërtohet nga depozitime të formacionit mbulesor Kuaternar, të kategorisë aluvionale

a) Formacioni Rrënjësor Mbulesor i Kuaternarit

Në përgjithësi këto depozitime ndërtohen nga depozitime të pakonsoliduara në formën e tokës vegetale. Materiali në to është i pakët dhe i përzier me lëndë organike bimore e drusore.

b) Depozitimet e Shkrifta

Nga pikepamja e depozitimeve, marrin pjesë depozitimet e Kuaternarit (Holocen), që dalin në sipërfaqe në harkun veri-perëndimor. Vetë sektori përfaqësohet nga depozitime të karakterit aluvional, të shkrifta, që hyjnë në marrëdhënie normale apo me diskordancë me shkëmbinjtë përreth. Zona në studim ndërtohet, si në sipërfaqe dhe në thellësi deri në nivelet e rendeve 10-15m nga depozitime të Kuaternarit, (Holocenit).

c) Depozitimet deluvionale

Zenë vend kryesisht pranë shpateve të kodrave të ndërtuar me depozitime të formacionit rrenjesor dhe kapin një trashësi 5m, e që reduktohen drejt lindjes duke kaluar facialisht në depozitim aluvional. Shpesh lidhen me pjesën e sipërme të fushës aluvionale. Perfaqësohen nga dhëra me guriçka, suargjila të lehta në të mesëm, me pak lagështi, në gjendje plastike dhe mesatarisht të ngjeshura. Here here takohen rëra të verdha, mbeturina flore, alevrolite.

d) Depozitimet aluvionale

Ndertojnë pjesën më të madhe të sipërfaqes së zenë nga shkëmbinjtë mbulesore, që së bashku me ato deluvionale perbejnë sipërfaqen e tokës së bukës. Kap një trashësi deri 10m, e që trashet drejt lindjes. Perfaqësohet kryesisht nga suargjila të mesëm deri të renda, ngjyrë bezhë në kafe, me lagështi, plastike deri pak të ngjeshura. Në zonat pranë shtrateve të rrjedhjeve ujore shpesh përfaqësohen prej surerave të lehta, rera lumi deri në zhavorre k/mesëm, me fraksione zhavori e breza rërash të imta e suargjilash të ngopura me ujë e mesatarisht të ngjeshura.

2.3. INFORMACION PËR PRANINË E BURIMEVE UJORE

2.3.1. Pershkrimi hidrogeologjik i zonës

Nga pikepamja hidrogeologjike, rajoni ynë ben pjesë në pellgun e madh artezian të Ultesires Perendimore, i cili është i pasur me ujra nëntokësore. Kjo është e kushtezuar nga përhapja e shkëmbinjeve me veti të mira dhe mesatare kolektore (zhavorre dhe konglomerate), nga kushtet e favorshme klimatike me reshje rreth 1100mm/vit, nga një rrjet i dendur hidrografik dhe me relief fushor me pjerrësi të vogël drejt lindjes. Duke u bazuar në kriterin litologo-stratigrafik, në zonën në studim veçohen dy komplekse kryesore ujembajtëse:

- A. Kompleksi ujembajtës i depozitimeve të shkrufta Kuaternare (Q2);
- B. Kompleksi ujembajtës i depozitimeve molasike të perfaqesuara nga ranoret e suites Mëzesi të Miocenit të Sipërm.

A. Kompleksi ujembajtës i depozitimeve të shkrufta Kuaternare

Ky kompleks ujembajtës përhapet në të gjithë rajonin e studjuar i në njesinë geomorfologjike fushore. Simbas ujëpershkueshmerisë dhe ujëmbajtjes, brenda këtij kompleksi dallojmë këto horizonte ujëmbajtëse:

- Horizonti ujembajtës i rerave dhe i surerave aluviale me përhapje në të gjithë njesinë fushore, me një përshkueshmeri mesatare deri të vogël dhe ujëmbajtje të vogël. Horizontet e lartëpërmendur kanë ujëra pa presion.
- Horizontet ujembajtëse me presion të zhavorreve aluviale me përshkueshmeri të lartë, përhapje të gjerë në të gjitha luginat lumore të rrjedhjes së poshtëme dhe me ujëmbajtje të madhe.

B. Kompleksi ujembajtës i depozitimeve mollasike

Ranoret e suites Mëzesi formojnë disa shtresa apo horizonte ujembajtëse me trashësi 5-8m, të ndara midis tyre prej shtresave argjilore me trashësi disa metrash. Burimet që dalin nga ranoret në strukturat e ulura të Tiranës japin ujë me debit mesatar të rendit 0,1-0,5 l/s (me të shpeshta ato me $Q = 0,2$ l/s), shpesh me karakter stinor në varësi të reshjeve. Vetite filtruese të ranoreve varen, si nga poroziteti dhe çarshmeria, ashtu dhe nga shkalla e çimentimit të tyre. Me veti me të larta filtruese karakterizohen ranoret me çimentim të dobët deri në të shkruftat. Shkëmbinjtë e zones së ajrimit janë të përshkueshem nga uji gjë që ndikon në regjimin e burimeve ujore. Prurja e puseve me vetederdhje, përgjithësisht lekundet nga 0.5-1.2 l/s (depressioni i Tiranës), 0,6-0,8 l/s në pusët e krahut perendimor të depressionit të Tiranës.

2.3.2. Pershkrimi hidrologjik i zonës

Ushqimi kryesor i rrjetit hidrografik janë reshjet e shiut, gjë kjo që shprehet edhe në veçoritë e regjimit të rrjedhjes vjetore. Në stinën e verës, prurja e përrenjve pakësohet aq shumë, sa që një pjesë e tyre që e furnizojnë thahet plotësisht. Kjo vjen nga mungesa e reshjeve gjatë verës, por edhe nga burimet shumë të pakta e të vogla nëntokësore, për shkak të përhapjes së formacioneve të papërshkueshme.

Të dhëna për burimet ujore të zonës

Në këtë zonë ka një numër përrenjesh të vegjël të krijuar nga zona kodrinore, veçse këto nuk mund të konsiderohen si burim serioz i ujit, pasi jetëgjatësia e tyre pas shiut është relativisht e shkurtër. Këta përrenj sjellin ujë kryesisht gjatë stinës së lagësht, duke ndikuar në pëmbytjen e tokave të zonës fushore dhe të ndodhura pranë tyre dhe në mënyrë të veçantë nxisin shfaqjen e koefiçentitëve të lartë të erozionit. Tani të gjitha skemat janë në vartësi dhe nën menaxhimin privat nga vetë banorët e zonës dhe strukturat e zgjedhura prej tyre.

Burimet artificiale

Në këtë zonë ndodhen rezervuarë të vegjël, që nuk paraqesin probleme me kanalet, portat për rregullimin e lëvizjes së ujit, etj. Në këtë mënyrë, ato aktualisht janë jashtë pune, por kapacitetet e tyre janë të konsiderueshme dhe mund të mbulojnë me ujitje gjatë sezonit të verës sipërfaqe të mëdha. Në sektorin e Selitës, takohen mbi dhjetë burime, që dalin në sipërfaqe me një gjatesi 400-450m. Prurja e burimit më të madh është rreth 550l/sek. Së bashku, të gjithë burimet japin rreth 800l/sek. Krahas tyre dalin dhe shume burime të tjerë të vegjël. Prurja e përgjithëshme e burimit të Selitës, i matur sistematikisht gjatë një periudhe pesë vjeçare (1967-1972) nga Instituti i Hidrometeorologjisë rezulton 400l/sek (në tetor) deri në 1080 l/sek (në prill). Karakteristika e këtyre burimeve është temperatura e lartë (14-15 gradë). Temperatura e lartë e burimeve të Selitës, nga disa autorë mendohet, që vjen nga lidhja hidraulike e këtyre burimeve, neujtrat sipërfaqësorë. Temperatura e lartë (14-15o) të ujit, të këtyre burimeve (në raport me burimet e tjera karstike të vendit) mendohet se situata gjeologjike, në rajonin e Dajtit është mjaft e ndërlikuar, ku gëlqerorët e eocenit kontaktojnë tektonikisht në perendim me një seri mergelore paleogenike (pjesa e facies paleogenike të zones Jonike). Prishja tektonike bie në lindje me kend 35-400. Fakti, që burimet e Selitës janë me temperatura të larta (14-15o) dëshmon se kemi të bëjmë me ujra ngjites, që mesa duket vijnë nga thellësia, të pakten 500m, duke marrë parasysh një mesatare ngrohje prej 1 grade për 33m thellësi, (gradienti gjeotermik). Prurja e madhe e burimeve karstike të Selitës, që drenojnë gjatë prishjes tektonike (700-1000 l/sek), mendojme se si zonë ushqimi i tyre është masivi i gëlqerorëve të Dajtit, i cili ka permasa të konsiderueshme, duke marrë parasysh, veç daljes se tij në sipërfaqe dhe vazhdimësinë e tij, nën depozitimet kodrinore.

Uji i pijshëm

Prodhimi i përgjithshëm i UKT-së është 84% prej burimeve me rrjedhje të lirë, që do të thotë: Liqeni i Bovillës dhe burime të tjera, ndërsa mbetja prej 16% prej puseve nëntokësore dhe stacioneve përkatëse të pompimit. Përsa i përket faturimit, llogaritet 43% është konsumuar nga përdoruesit familjarë, 7% nga subjektet private, 6% nga institucionet dhe pjesa tjetër, rreth 44%, për komunat dhe bashkitë e tjera rreth Bashkisë së Tiranës. Burimet ujore të Bashkisë së Tiranës janë: 1) Uji sipërfaqësor nga Liqeni i Bovillës; 2) Tri burime nëntokësore; 3) Ujë nëntokësor nga 9 puse. Uji sipërfaqësor trajtohet në Impiantin e Trajtimit të Ujërave të Bovillës dhe më pas transferohet në rrjetin e shpërndarjes dhe rezervuarët e shpërndarjes. Ujërat e burimeve dhe ujërat nëntokësorë transmetohen pas klorinimit drejtpërdrejt në rrjet ose në rezervuarë. Vërehet se ka mjaft rezervuarë jashtë Bashkisë së Tiranës për furnizimin me ujë të zonave fqinje. Kapaciteti i burimeve të ndryshme ujore (Liqeni i Bovillës, tri burimet dhe nëntë puset), është 3450 m³/ sek (298000 m³/ditë), sasi e mjaftueshme për të mbuluar zonën e shërbimit të UKT-së. Veçanërisht Liqeni i Bovillës ka rezerva ujore të mjaftueshme edhe për kërkesat e ardhshme. Cilësia e ujit të Liqenit të Bovillës është e mirë dhe kategorizohet si Klasë A në standardet mjedisore të cilësisë së ujit, ndërsa puset fushore rrezikojnë të mbyllen për shkak të mos trajtimit të ujërave të zeza pranë zonave rrethuese të puseve.

2.4 INFORMACION LIDHUR ME IDENTIFIKIMIN E NDIKIMEVE TË MUNDSHME

2.4.1 Ndikimi në mjedis dhe në veprat përreth

Për të analizuar ndikimet të mundshme në mjedis janë vlerësuar burimet dhe shkaqet e këtyre ndikimeve të mundshme. Ndërtimi i linjave të transmetimit të energjisë, do t'i japë një pamje tjetër qytetit duke ndikuar drejtpërdrejt në:

- Rritjen e kapacitetit të transmetimit në Shqipëri e veçanti në zonën urbane të Tiranës dhe Rrashbull;
- Rritjen e sigurisë dhe cilësisë së furnizimit me energji në sistemin e transmetimit në Shqipëri.
- Sigurimin e fuqizimit të sistemit të transmetimit me Unazën e Tiranës, Rrashbull dhe të Fierit.
- Reduktimin e problemeve gjatë kushteve ekstreme të motit.
- Reduktimin e humbjeve teknike;
- Reduktimin e energjisë së pafurnizuar;
- Reduktimin e kostos së operimit (mirmbajtje dhe siguri);
- Reduktimin e kapaciteteve të nevojshme për të kompesuar humbjet e medha;
- Rritjen e aftësisë transmetuese.

Sipas studimit të deritanishëm, nuk është identifikuar asnjë “ndikim negativ fatal”, por ekzistojnë vetëm ndikime pozitive, të cilat do të zhvillojnë këto zone, si dhe do kontrollohen disa masa zbutëse organizative për të shmangur ndonjë ndikim negativ rastësor nga ato të lidhura me aksidentet njerëzore.

Tabelë përmbledhëse e ndikimeve, që do të gjenerohen nga zhvillimi i aktivitetit

| Burimi i Ndikimeve | Objekti mbi të cilin bien | Lloji i ndikimit |
|--|-----------------------------------|---|
| Furnizimi me energji elektrike | Banorët vendas Biznesin vendas | +++ , Rritjen e nivelit të tensionit në konsumator |
| Montimi i linjës 110kV sipas standarteve | Banorët vendas Biznesin vendas | +++ , Eliminimi i mundësisë së abuzimit me energjinë elektrike të abonenteve keqdashës; |
| Shfrytëzimi i energjisë elektrike në cilësinë dhe standartet evropianë | Banorët vendas Biznesin vendas | +++ Përmirësimin e sistemit të transmetimit në nivelet lokale +++ , Rritja e fuqizimit i bizneseve. +++ , përballimin e ngarkesave gjatë sezonit të verës |
| Zhvillimi i industrisë së turizmit | Ekonomia e komunitetit | + + , ulja e efekteve të papunësisë së zonës + + , përmirësimi i jetesës së banorëve të zonës. |
| Shfrytëzimi i fuqisë punëtore. | humane | +++ , Rritja e punësimit në komunitet. |
| Rritja e aksesit të zonës (për përdorim-shfrytëzim, rikrijim) | Mjediset humane | + + + , konsiderohet si mjaft positive. |
| Mundësi investimesh | humane | +++ , rritja e punësimit në komunitet. |
| Gjenerimi i mbeturinave | Mjediset urbanë | + , menaxhimi rigoroz i tyre |

Shpjegim :

- , Ndikim negativ i konsiderueshëm
- , Ndikim negativ i lartë
- , Ndikim negativ shumë i lartë
- ? , Ndikim negativ që mund të mos ndodhë, por që duhet marrë në konsideratë.
- + , Ndikim pozitiv
- + + , Ndikim pozitiv i konsiderueshëm
- + + + , Ndikim pozitiv shumë i lartë.

Ky aktivitet ka një fokusim të gjerë në rritjen e ndikimeve pozitive gjatë zbatimit të këtij projekti.

2.4.2 Ndikimi në mjedis gjatë punimeve të ndërtimit

Ndotja mund të vijë, si nga pluhuri që do krijohet nga punimet e ndërtimit të përkohshëm në sheshin e gropave të shtyllave, që do të ndërtohet, si dhe nga ngarkesat gjatë qarkullimit të automjeteve, ashtu edhe nga rritja e lëvizjes së mjeteve të motorizuara dhe të rënda.

Tabelë përmbledhëse e ndikimeve në mjedis

| <i>Burimi i Ndikimeve</i> | <i>Objekti mbi të cilin bien.</i> | <i>Lloji i ndikimit</i> |
|--|--|--|
| Pajisja e punonjësve me veshjet e duhura (maska, kufje kundra zhurmave, veshje specifike etj). | Tokë. Banorët vendas, punonjësit Biznesin vendas | - -, ndotje minimale nga gjenerimi i pluhurave (duke marrë parasysh udhëzimet gjatë gjenerimit të pluhurave). - - , Ndotje akustike – shqetësim për punonjësit. |
| Aksidente të mundshme gjatë procesit të hapjes së gropave në brendësi të tokës | Punonjësit, | - , Rritja e mundësisë për aksidente. |
| Shfrytëzimi i fuqisë punëtore | humane | +++ , Rritja e punësimit në komunitet. |

Shpjegim:

- , Ndikim negativ i konsiderueshëm
- , Ndikim negativ i lartë
- , Ndikim negativ shumë i lartë
- ?, Ndikim negativ që mund të mos ndodhë, por që duhet marrë në konsideratë.
- + , Ndikim pozitiv
- ++ , Ndikim pozitiv i konsiderueshëm
- +++ , Ndikim pozitiv shumë i lartë.

Ky aktivitet ka një fokusim të gjerë në zbutjen e ndikimeve negative dhe rritjen e atyre pozitive gjatë zbatimit të këtij projekti.

Ndikimi negativ në ujëra sipërfaqesore

Aktiviteti nuk përdor dhe nuk shkarkon ujëra që të ketë ndikime negative në sipërfaqe në terren.

Ndikimi negativ në tokë

Aktiviteti nuk do të ketë ndikime negative në tokë sepse nuk do lejohen që mbetjet të rrinë të hapërdara në ambejnte jashtë saj.

Ndikimi në reliefin e zonës

Zona që do të gëryhet dhe transportimi i sedimentit nuk do të shkaktojë ndryshime në reliefin dhe topografinë e zones, sepse gropat do të mbulohen po me dheun e gërmuar dhe do të ngjeshet, dhe kjo do të bëjë që sheshi i punimeve do të mbetet i njëjtë. Ky impakt konsiderohet i papërfillshëm, pasi germimi i gropave do të bëhet brenda një periudhe të shkurtër kohe dhe rëzimet e dherave do të pastrohen në mënyrë që të shmangët përhapja në zonën përreth.

Tabela: Vlerësimi i ndikimeve negative më të rëndësishme në mjedis

| <i>1.Lloji i ndikimit</i> | <i>2. Faza e përgatitjes së punimeve të gërmimit të gropave</i> | <i>3. Faza e punimeve në rrugët ndihmëse të linjës</i> | <i>4. Faza e funksionimit të linjës</i> |
|-------------------------------------|---|--|---|
| Ndikime në topografinë e territorit | aspak | aspak | aspak |

| | | | |
|---|----------------------------|----------------------------|---------------------|
| Shqetësimet në burimet ujore dhe agrokultura | aspak | aspak | aspak |
| Varfërimi i shtresës sipërfaqësore nga biomasa | Të pakonsiderueshme | Të pakonsiderueshme | Të pakonsiderueshme |
| Shqetësimet nga mbeturina personale të punonjësve dhe mbetje inerte | Relativisht të rëndësishme | Relativisht të rëndësishme | aspak |

2.4.3. Ndikimi në Ndotjen e ajrit nga pluhurat

Duke pasur parasysh kohën e shkrutës të gerryerjes, mendohet që çlirimi i mundshëm i pluhurave nuk do të ketë efekt mjedisor, sepse do të jenë lokale dhe të përqendruar pranë pikës së gerryerjes dhe do të jenë me karakter të përkohshëm.

Tabelë përmbledhëse e ndikimit në ndotjen e ajrit nga pluhurat të gjeneruara nga ky projekt

| <i>Burimi i Ndikimeve</i> | <i>Objekti mbi të cilin bien</i> | <i>Lloji i ndikimit</i> |
|--|---------------------------------------|---|
| Hapja e gropave ku do të vendosen bazamente e shtyllave të reja | Ajër. Punonjësit Biznesi vendas | -, ndotje minimale e ajrit nga gjenerimi i pluhurave. - -, Ndotje akustike. |
| Aksidente të mundshme gjatë procesit të hapjes së gropave dhe gërryerjeve të tokës | Punonjësit, | -, Rritja e mundësisë për aksidente. |
| Gjenerimi i mbeturinave | Mjediset urbanë | +, menaxhimi rigoroz i tyre |
| Gjenerimi i mbeturinave personale | Punonjësit | ++, Të gjitha mbetjet personale nga konsumimi personal i punonjësve do të menaxhohen me kujdes. |

Shpjegim:

- , Ndikim negativ i konsiderueshëm
- , Ndikim negativ i lartë
- , Ndikim negativ shumë i lartë
- ? , Ndikim negativ që mund të mos ndodhë, por që duhet marrë në konsideratë.
- + , Ndikim pozitiv
- ++ , Ndikim pozitiv i konsiderueshëm
- +++ , Ndikim pozitiv shumë i lartë.

2.4.4. Ndikimi në zhurma

Ndikimet lokale në rritje të niveleve të zhurmës parashikohen të kenë ndikim negativ në cilësinë e jetës për punëtorët të zonës. Oraret e punës do të kufizohen në përputhje me standartet kombëtare. Me zhurmat janë të lidhura dhe shqetësimet nervore, streset dhe pagjumësia. Zhurmat mund të shkaktojnë çrregullime të gjumit, çrregullime të komunikimit, dëmtime në dëgjim, efekte kardiovaskulare, efekte psikologjike, mërzitje deri në ndryshime të sjelljeve sociale. Ekspozimi për pak kohë në zhurma më shumë se 140dB(A) sjell shurdhim të menjëhershëm. Ndërsa ekspozimi për disa vjetë në zhurma mbi 85 dB(A) sjell një shurdhim gradual. Ekranet akustikë të qarkullimit si dhe përdorimi i materialeve kundra zhurmave në ndërtim, ulin nivelin e dëgjimit të zhurmave nga 5-15dB.

Tabela: Vlerësimi i ndikimeve negative më të rëndësishme në mjediset humane

| <i>1.Lloji i ndikimit</i> | <i>2. Faza e përgatitjes së punimeve të gërmimit të gropave</i> | <i>3. Faza e punimeve të në rrugët ndihmëse të linjës</i> | <i>4. Faza e funksionimit të linjës</i> |
|-----------------------------|---|---|---|
| Shqetësimet nga zhurmat dhe | Të lehta | Relativisht | Relativisht |

| dridhjet gjatë operacioneve të punës | | të rëndësishme | të pa rëndësishme |
|--|----------|----------------------------|-------------------------------|
| Shqetësimet nga zhurmat, dridhjet dhe pluhurat gjatë transportit të materialeve | Të lehta | Të rëndësishme | Relativisht të pa rëndësishme |
| Shqetësimet nga mbeturina personale të punonjësve dhe mbetje të paisjeve elektrike | Të lehta | Relativisht të rëndësishme | aspak |

Kjo veprimtari ndërtuese do të ketë një kohëzgjatje jo shumë të gjatë falë teknikës dhe teknologjisë së re dhe moderne që sot ka hyra nëpër kantieret e ndërtimit. Kështu që vetëm për banorët e zonës do të vihet re prania e mjeteve, zhurmave, trafikut apo edhe ndryshimit gradual të panoramës, ndërsa për kalimtarët e rastit nuk do të jetë ndonjë bezdi fakti i të qenit të një kantieri. Ndikimet negative të gërmimit nuk do përfshijnë dëmtimin direkt potencial ndaj florës dhe faunës në zonat e gërmimit dhe të hedhjes së materialit të gërmuar, por ndërthurjen e transportit të materialit të gërmuar me trafikun ekzistues që në zonë është shumë intensiv si dhe ndotjen e zhurmën gjatë punës së pajisjeve gërmues. Edhe pse ky impakt, në aktivitete të tilla sot konsiderohet i vogël, pasi gropat mbushen menjehere brenda një periudhe të shkurtër kohe me material drenazhues dhe stabilizat rruge për zbutjen e forcave të ferkimit të automjeteve me rrugen. Për më tepër, efekti është i shkrutër dhe kushtet normale do të rikthehen pas periudhës së gërmimeve.

2.4.5. Ndikimi në mjedis nga Depozitimi i dherave të gërmuar

Gjatë punës gerryese për thellimin e gropave të themeleve të shtyllave, do të përdoren metodat normale të gërmimit dhe duke përdorur praktika të mira menaxhimi, si dhe duke i depozituar në sheshe ku Bashkia do të miratojë. Ky impakt konsiderohet i vogël, pasi punimet e gërmimit do të bëhen brenda një periudhe të shkurtër kohe dhe dherat do të pastrohen në mënyrë që të shmangët përhapja në zonën përreth.

2.4.6. Ndikimi në biodiversitet

Ndikimet negative të shkaktuara në biodiversitet nga dridhjet, pluhurat dhe zhurmat kanë vetëm rrugë reduktimi. Përsa i përket humbjes së biomasës në territorin që do të kryhen punime montimi linje, habitateve të fragmentizuara do të merren masat si gjelbërimi përgjate shtrirjes së linjës, që do të rrisë sipërfaqet e gjelbëruara, gjë e cila garanton diellzimin e nevojshëm dhe nxitjen e zhvillimit të specieve të tjera spontane. Në këtë mënyrë mund të sigurohet një vazhdimësi natyrore e vegjetacionit në zonat përreth.

2.4.7. Ndikimet në sipërfaqet ujore

Nga punimet e ndërtimit të linjës elektrike, në këtë zonë nuk do të ketë ndikime negative në modelin drenazhues të tokës pasi nuk prek sisteme të ndryshme drenazhimit të ndërtuara.

2.4.8. Vlerësimi dhe identifikimi i ndikimeve negativ në mjedis

Si çdo objekt tjetër, që ndërtohet në një mjedis të caktuar deri në arritjen e formës së caktuar ka një sërë punimesh ndërtimi dhe montimi. Funkionimi i aktiviteteve të tilla në këto zona ka veçorinë, që kërkon ngritjen e një infrastrukture të përshtatshme me plane menaxhimi mjedisore gjatë punimeve të ndërtimit edhe nga ana vizuale dhe funksionale si:

- sheshin e objektit, i cili sistemohet dhe drenazhohet nga ujrat sipërfaqesore;
- vlerësimin dhe identifikimin e ndikimeve në mjedis si me poshte:

VLERËSIMI I NDIKIMEVE NEGATIVE E POZITIVE GJATË FUNKSIONIMIT TE VERPES

| <i>Lloji i ndikimit në tokë</i> | <i>Identifikimi i ndikimit</i> | | | |
|---|--------------------------------|-----------|---------------------------|-----------|
| | <i>Gjatë ndërtimit</i> | | <i>Gjatë shfrytëzimit</i> | |
| | <i>Po</i> | <i>Jo</i> | <i>Po</i> | <i>Jo</i> |
| Ndryshime topografike të terrenit | | x | | x |
| Prishja e tokës bujqësore | | x | | x |
| Ndotja e tokës nga rrjedhjet | | x | | x |
| Ndotja e tokës nga mbetjet e ngurta | x | | | x |
| Ndotja e tokës nga depozitimet e llumrave | | x | | x |
| <i>Lloji i ndikimit në cilësinë e ajrit</i> | <i>Identifikimi i ndikimit</i> | | | |
| | <i>Gjatë ndërtimit</i> | | <i>Gjatë shfrytëzimit</i> | |
| | <i>Po</i> | <i>Jo</i> | <i>Po</i> | <i>Jo</i> |
| Prodhimi i areosolave | | x | | x |
| <i>Lloji i ndikimit në florën dhe faunës</i> | <i>Identifikimi i ndikimit</i> | | | |
| | <i>Gjatë ndërtimit</i> | | <i>Gjatë shfrytëzimit</i> | |
| | <i>Po</i> | <i>Jo</i> | <i>Po</i> | <i>Jo</i> |
| Shkatërrimi i rëndësishëm i habitateve natyrore | | x | | x |
| Rrezikimi i ndërhyrjes në bimët e ujit | | x | | x |
| Ndërtimi i rrugëve të reja që kalojnë përmes zones së virgjër | | x | | x |
| Përçarje apo izolim të habitateve të egra | | x | | x |
| Interferencë midis rrugës natyrore të emigrimit të sisonëve | | x | | x |
| <i>Lloji i ndikimit në ujë</i> | <i>Identifikimi i ndikimit</i> | | | |
| | <i>Gjatë ndërtimit</i> | | <i>Gjatë shfrytëzimit</i> | |
| | <i>Po</i> | <i>Jo</i> | <i>Po</i> | <i>Jo</i> |
| Trajtimi i ujrave të ndotur | | x | | x |
| Ndotja e ujit prej pluhurit, hidrokarbureve, derdhjeve aksidentale dhe substancave të tjera | x | | | x |
| Impakti sekondar në ndotjen e ujit për toka bujqësore, ujrat nëntokësore etj. | | x | | x |
| Modifikim në drenazhimin e ujrave natyrore | | x | | x |
| Ndotja e ujrave sipërfaqësore dhe nëntokësore nga llumrat | | x | | x |
| <i>Lloji i ndikimit në ndotjen nga zhurmat</i> | <i>Identifikimi i ndikimit</i> | | | |
| | <i>Gjatë ndërtimit</i> | | <i>Gjatë shfrytëzimit</i> | |
| | <i>Po</i> | <i>Jo</i> | <i>Po</i> | <i>Jo</i> |
| Rritja e nivelit ekzistues të zhurmave | x | | | x |
| Rritja e nivelit të zhurmave si rezultat i aktivitetit dhe makinave | x | | | x |
| Rritja e nivelit të zhurmave për njerëzit | x | | | x |
| Niveli më i lartë i zhurmave për kafshët | x | | | x |
| <i>Lloji i ndikimit në përfitimin e tokës</i> | <i>Identifikimi i ndikimit</i> | | | |
| | <i>Gjatë ndërtimit</i> | | <i>Gjatë shfrytëzimit</i> | |
| | <i>Po</i> | <i>Jo</i> | <i>Po</i> | <i>Jo</i> |
| Shkatërrim banesash | | x | | x |
| Ndryshime të rëndësishme në programet për të ardhmen e përdorimit të tokës | | x | | x |
| Rivendosje banesash | | x | | x |
| Shpronësime të tokës | | x | | x |
| <i>Lloji i ndikimit për trashëgiminë kulturore</i> | <i>Identifikimi i ndikimit</i> | | | |
| | <i>Gjatë ndërtimit</i> | | <i>Gjatë shfrytëzimit</i> | |
| | <i>Po</i> | <i>Jo</i> | <i>Po</i> | <i>Jo</i> |

| | | | | |
|---|--------------------------------|-----------|---------------------------|-----------|
| Ndryshime apo dëmtime të zonave arkeologjike apo me vlerë historike e kulturore | | x | | x |
| Lloji i ndikimit në energji | Identifikimi i ndikimit | | | |
| | Gjatë ndërtimit | | Gjatë shfrytëzimit | |
| | Po | Jo | Po | Jo |
| Përdorim i sasive të mëdha të karburantit për energji | | x | x | |
| Rritje të rëndësishme të kërkesave për burime ekzistuese të energjisë apo kërkesave për tipe të reja të energjisë | | x | x | |
| Lloji i ndikimit në interesin publik (infrastruktura) | Identifikimi i ndikimit | | | |
| | Gjatë ndërtimit | | Gjatë shfrytëzimit | |
| | Po | Jo | Po | Jo |
| Ndryshimi i destinacionit të aktivitetit do të ketë apo jo nevojë për ndryshim në këtë fushë të interesit publik | | x | x | |
| Energji elektrike | | x | | x |
| Sistemin e komunikacionit | | x | | x |
| Sistemin e kanalizimit të ujrave të zeza dhe të bardha | | x | | x |
| Sistemin e ujësjellësit | | x | | x |
| Mbetjet e ngurta dhe depozitimi i tyre | x | | | x |
| Lloji i ndikimit në shëndetin publik | Identifikimi i ndikimit | | | |
| | Gjatë ndërtimit | | Gjatë shfrytëzimit | |
| | Po | Jo | Po | Jo |
| Krijimi i çfarëdo rreziku apo mundësie për dëmtimin e shëndetit të njerëzve | | x | | x |
| Krijimi i raportit të njerëzve me rreziqet e mundëshme për dëmtimin e shëndetit publik | | x | | x |
| Lloji i ndikimit në qarkullim dhe transport | Identifikimi i ndikimit | | | |
| | Gjatë ndërtimit | | Gjatë shfrytëzimit | |
| | Po | Jo | Po | Jo |
| Shtime të rëndësishme të qarkullimit të automjeteve | x | | | x |
| Pakësime të vendqendrimeve të automjeteve apo nevoja për vendqendrime të reja | | x | | x |
| Ndikime të rëndësishme në sistemin e komunikacionit | | x | | x |
| Ndryshime në qarkullimin apo lëvizjen e njerëzve | x | | | x |



2.5 SHKARKIMET E MUNDSHME NË MJEDIS

2.5.1. Çlirime të pluhurave nga punimet e ndërtimit

Në këtë aktivitet do të jenë present ekzistenca e pluhurit gjatë ndertimit, sepse do të ketë operacione pune që do të shkaktojnë pluhura që do të jenë present vetëm gjatë punimeve të gërmimit të gropave të themeleve të shtyllave. Çlirimet e pluhurave në ajër lidhen me fazat e punimeve në ndërtim:

- Përgatitja e zonës për ndërtim që përfshin nivelimin dhe stabilizimin e dheut;
- Shkarkimet në ajër do të jenë në nivele minimale pasi nuk kemi të bëjmë me procese të ndërlikuara kimike dhe do të merren të gjitha masat e nevojshme për reduktimin e pluhurave dhe grimcave të imta duke e rrethuar ambientin e punës si edhe duke e spërkatur me ujë.

2.5.2. Shkarkimet në ajër të Gazeve

Aktiviteti nuk ka të bëjë me prodhimin e gazeve të çfarëdolloj qofshin ato si serë apo dicka tjetër pasi nuk kemi të bëjmë me procese të ndërlikuara kimike.

2.5.3 Shkarkimet e ujërave të ndotura

Gjatë kryerjes së punimeve të gërmimit dhe montimit të shtyllave nuk do të ketë shkarkime të ujërave të përdorura në rrjetin magjstral shtetëror. Aktiviteti kryhet në një ambient të gatshëm, ku gjatë montimit të shtyllave nuk do ketë shkarkime ujore në ambiente sipërfaqësore e as në ato nëntokësore.

2.5.4. Shkarkime në ujërat sipërfaqësore në punimet e ndërtimit

Ndërtimi i kësaj linje dhe montimi i shtyllave nuk do të ketë ndikime negative në modelin drenazhues të tokës pasi nuk do të prek sisteme të ndryshme të ndërtuara ose të projektuara drenazhimi.

2.5.5 Zhurmat

Gjatë fazes së ndertimit, si pasoje e punimeve të gërmimit të themeleve të shtyllave do të rritet niveli i zhurmave në zonën e ndertimit. Zhurma gjatë procesit të punës do të ketë. Ato do të jenë present gjatë procesit të punës por do të jenë brenda normave të lejuara dhe me intervale të shkurtra kohore. Puntorët do të jenë të pajisur me mjete mbrojtëse kundra zhurmave si kufje etj. Zhurma nuk do të jetë shqetësim kryesor në zonat rrethuese të vendit të përzgjedhur. Niveli i zhurmave krijuar nga punimet e ndertimit, pritet të jetë i papërfillshëm me kohe minimale dhe do të jenë brenda normave të lejuara të zonave urbane.

2.5.6. Shkarkimi i materialit nga gërmimet

Mund të jetë e nevojshme të shkarkohen disa materiale të tepërta nga vendi në një vendndodhje jashtë vendit.

2.5.7. Lëkundje

Lëkundje nuk do të ketë, sepse pajisjet lëvizëse janë shumë të pakta në numër dhe me fuqi të ulët dhe me konstruksione, që garantojnë punë në ekuilibër të plotë.

2.5.8. Nriçimi

Nriçimi që do të përdoret gjatë ditës është drita e diellit, sepse do të punohet vetëm gjatë dites.

2.5.9. Vibrimet

Vibracionet e lindura prej punës në pajisjet teknologjike si atë ngjeshëse do të jenë prezente por në nivelet e lejuara, për shkak të funksionimit bashkëkohor të pajisjeve.

2.5.10. Nxehtësi

Nxehtësi nuk do të çlirohet gjatë procesit të punës sepse nuk do të përdoren pajisje që çlirojnë nxehtësi, pra nuk do të sjellë ndikim negativ në mjedis, si në ujërat sipërfaqësorë dhe ato nëntokësorë ose në ajër ose në shëndetin njerëzor.

2.5.11. Shpërndarja e materialeve

Shpërndarja e materialeve gjatë procesit të ndërtimit do të bëhet me kamion. Shpërndarjet do të përfshijnë makina pune të lehta, ekskavatorë dhe mbajtës materiale mbushëse. Kufiri i shpejtësisë dhe mbushja e gropave, sistemimi i shesheve të punës, së bashku me spërkatjen me ujë të ambientit do të përdoren për të minimizuar gjenerimin e pluhurit nga ky aktivitet, duke bërë të mundur hapjen dhe mbulimin sa më shpejt.

2.5.12. Mbetjet e krijuara

Nga procesi i ndërtimit të linjës dalin shumë pak mbetje të ngurta të cilat janë:

- ✓ Copa kartoni dhe amallazhe të dëmtuara
- ✓ Mbetje inerte gjatë punimeve të germimit dhe betonimit të bazamenteve të shtyllave.
- ✓ mbetjet e ndryshme të aktivitetit të furnizimit me lëndë përdoruese si kablllo, rrota druri etj., që dhe këto do të grumbullohen në kosha e zona të caktuara;

Këto do të jenë në sasira të vogla dhe nuk do të jenë të ndotura me lëndë të dëmshme për mjedisin. Këto mbetje do të hidhen në koshat e mbetjeve dhe do të përfundojnë në kontenier të mbetjeve bashkiake.

2.6 INFORMACION PËR KOHËZGJATJEN E MUNDSHME TË NDIKIMEVE NEGATIVE TË IDENTIFIKUARA

Impaktet potenciale në mjedis gjatë zhvillimit të projektit të ndërtimit të shtyllave të linjës dhe ndërtimit të N/Stacionit të ri Tirana3 do të përqendrohen si efekte të perkoheshme (në terma afatshkurter) që mund të ndodhin gjatë fazës së ndërtimit për shkak të aktiviteteve ndërtuese. Keto efekte të perkoheshme në mjedis do të jene të rigjenerueshme me kohe, kështu që mund të tolerohen gjatë kryerjes së punimeve të ndërtimit dhe montimit të linjës.

2.6.1. Analiza e ndikimit të perkoheshëm të punimeve të ndërtimit të themeleve të shtyllave të linjës

Kjo veprimtari ndërtuese e këtij sheshi do të ketë një kohëzgjatje relativisht të shkurtër falë teknikës dhe teknologjisë së re dhe moderne që sot ka hyrë në punimet e ndërtimit. Kështu që vetëm për punonjësit do të vihen re prania e mjeteve, zhurmave, trafikut apo edhe ndryshimit gradual të panoramës, ndërsa për kalimtarët e rastit nuk do të jetë ndonjë bezdi fakti i të qenit të një kantieri, aq më tepër që zona në fjalë është me linje dhe shtylla ekzistuese. Ndikimet negative të gërmimit nuk përfshijnë dëmtimin direkt potencial ndaj florës dhe faunës në zonat e gërmimit dhe të hedhjes së materialit të gërmuar, ndërthurjen e transportit të materialit të gërmuar me trafikun ekzistues tokësor dhe ndotjen e zhurmën gjatë punës së pajisjeve gërmues. Impakti i gërmimit dhe hapjes së gropave të shtyllave konsiderohet i vogël, pasi gropat do të ngjeshet dhe mbushet menjehere brenda një periudhe të shkurtër kohë me material drenazhues dhe betonarme dhe kullimin e ujrave për të shmangur lagështirën. Për më tepër, efekti është i shkurtër dhe kushtet normale do të rikthehen pas perfundimit të gërmimeve.

2.6.2 Analiza e ndikimit të perkoheshme të depozitimit të dherave të gërmuar në punimet e ndërtimit

Gjatë punës gerryese për thellimin e gropave të themeleve, nuk do të duhet të largohen sedimente sepse ato do të përdoren për mbulim me ngjeshje. Duke përdorur metodat normale të gërmimit dhe duke përdorur praktika të mira menaxhimi të ndonjë mbetje të krijuar do të depozitohen në sheshe ku bashkia ka miratuar. Në përgjithësi, largimi i sedimenteve ekzistuese dhe vendosja e tyre në një mjedis të përshtatshëm, ku parandalohet shpërndarja, ka një ndikim të ndjeshëm mbi mjedisin. Zona që do të gëryhet do të ndikohet nga rëzimet e dherave gjatë ngarkimit për ti transportuar në sheshin e miratuar për tu depozituar. Ky impakt konsiderohet i vogël, pasi gërmimi i gropave do të bëhet brenda një periudhe të shkurtër kohe dhe rëzimet e dherave do të pastrohen në mënyrë që të shmangjet përhapja në zonën përreth.

2.6.3. Analiza e ndikimit të perkoheshëm të çlirimit të pluhurave në punimet e ndërtimit

Në këtë aktivitet do të jetë present ekzistenca e pluhurit gjatë ndërtimit, sepse do të ketë operacione pune që do të shkaktojnë pluhura nga gërmimet e themeleve të shtyllave, por ndryshe nga shume aktivitete të tjera, ajo do të jetë present gjatë punimeve të gërmimit të gropave të themeleve.

Gjatë gerryerjes së sedimentit për hapjen e gropave të themeleve të shtyllave, do të çlirohen pluhura. Për këtë arsye sheshi i punimeve do të rrethohet me rjetë dhe do të lagen gjatë kohës së zhvillimeve të punimeve me makineritë duke përdorur praktika të mira menaxhimi të punimeve të

gërmimit. Duke pasur parasysh shkallen e moderuar të kontaminimit dhe kohën e shkruter të gerryerjes, mendohet që çlirimi i mundshëm i pluhurave nuk do të ketë ndonjë efekt mjedisor. Efektet, do të jenë lokale dhe të përqendruar pranë pikës së gerryerjes dhe do të jenë me karakter të përkohshëm.

2.6.4. Analiza e ndikimit të perkoheshëm nga Zhurmat në punimet e ndërtimit

Në konceptin fizik nuk ka asnjë dallim midis tingullit dhe zhurmës. Tingulli është një perceptim ndjesor dhe konfiguracioni kompleks i valëve zanore është përcaktuar (quajtur) me termat: zhurmë, muzikë, fjalë, etj. Zhurma është përcaktuar edhe si tingull i padëshirueshëm. Të gjitha matjet marrin parasysh përmbajtjen e frekuencës së zhurmës, nivelet e presionit akustik global dhe ndryshimin e këtyre niveleve në kohë. Për të krijuar një ide mbi nivelin e zhurmave po japim një tabelë krahasimore të zhurmave për mjedise të ndryshme.

| Niveli Tingullit | Pikënisja dëgjimit | Pëshpërima | Biseda | Trafiku Qytetit | Koncert Rock | Motor Jet 10 m larg |
|------------------|--------------------|------------|--------|-----------------|--------------|---------------------|
| dB(A) | 0 | 30 | 60 | 90 | 120 | 50 |

Gjatë fazes së ndërtimit, si pasojë e rritjes së volumit të materialeve do të rritet niveli i zhurmave në zonën e ndërtimit. Zhurma nuk do të jetë shqetësim kryesor në zonat rrethuese të vendit të përzgjedhur. Niveli i zhurmave krijuar nga ndërtimi i këtij projekti pritet të jetë i papërfillshëm dhe jo mbi normat e lejuara. Rritja e nivelit të zhurmave shkaktohet kryesisht nga aktivitetet e ngarkim/shkarkimit dhe levizjet e mjeteve transportuese. Ndikimet lokale në nivele të larta të zhurmës parashikohen të kenë ndikim negativ në cilësinë e jetes për punëtorët të zonës. Oraret e punës do të kufizohen në përputhje me standartet kombëtare. Zhurmat mund të shkaktojnë çrregullime të gjumit, çrregullime të komunikimit, dëmtime në dëgjim, efekte kardiovaskulare, efekte psikologjike, mërzitje deri në ndryshime të sjelljeve sociale. Ekspozimi për pak kohë në zhurma më shumë se 140dB(A) sjell shurdhim të menjëhershëm. Ndërsa ekspozimi për disa vjetë në zhurma mbi 85 dB(A) sjell një shurdhim gradual. Ekranet akustikë të qarkullimit si dhe përdorimi i materialeve kundra zhurmave në ndërtim, ulin nivelin e dëgjimit të zhurmave nga 5-15dB.

2.6.5 Analiza e ndikimit të perkoheshëm në biodiversitet në punimet e ndërtimit

Ndikimet negative të shkaktuara në biodiversitet nga dridhjet, pluhurat dhe zhurmat kanë vetëm rrugë reduktimi. Përsa i përket humbjes së biomasës në territorin që do të shfrytëzohet, habitateve të fragmentizuara do të merren masat si gjelbërimi përreth territorit të shtyllave, që do të rrisë sipërfaqet e gjelbëruara, gjë e cila garanton diellzimin e nevojshëm dhe nxitjen e zhvillimit të specieve të tjera spontane. Në këtë mënyrë mund të sigurohet një vazhdimësi natyrore e vegetacionit në zonat përreth.

2.6.6. Analiza e ndikimit të perkoheshëm në ujërat sipërfaqësore në punimet e ndërtimit

Nga punimet e ndërtimit kësaj linje dhe montimi i shtyllave nuk do të ketë ndikime negative në modelin drenazhues të tokës pasi nuk do të prek sisteme të ndryshme të ndërtuara ose të projektuara drenazhimi.

2.6.7. Analiza e ndikimit të perkoheshëm në ndryshimet e karakteristikave hidrografike nga punimet e ndërtimit

Ushtrimi i këtij aktiviteti në kushte optimale në këtë zonë, nuk do të ndikojë në nivelin e ujrave tokësore, në rrugët ujore dhe në rrjedhën e ujrave nëntokësore. Në zonën e projektit dhe përreth saj,

ka burime ujore nëntokësore, por zbatimi i rekomandimeve nga projektet e veçanta do të bëjë që ato të ruhen e të mos preken.

2.6.8. Analiza e ndikimit të perkoheshëm nga derdhje aksidentale e sedimentit gjatë punimeve të ndertimeve (derdhje e naftes)

Gjatë ndërtimit, risku i derdhjes aksidentale të karburantit në tokë duhet të merret parasysh në planin e menaxhimit mjedisor. Rreziku i derdhjeve të vajrave gjatë ndërtimit do të jetë prezentë pasi një sasi e caktuar makinash të medhaja do të jenë duke punuar në këtë zonë. Vajrat në se derdhen në tokë do të ndotin dherat dhe ujrat sipërfaqesore.

2.6.9. Analiza e ndikimit në aktiviteti human

Transporti lokal në zonë nuk do të ndikohet negativisht nga rritja e trafikut të mjeteve të renda dhe e clirimeve në ajer të motorreve të tyre. Operacionet në punimet e ndërtimit nuk do të ndikojnë në nuk do të ndikojnë në zonën e projektit.

2.6.10. Analiza e ndikimit të perkoheshëm në Sigurinë e shendetit dhe mjedisit gjatë punimeve

Veprimtaritë ndërtimore të ketyre llojeve gjithmonë do të paraqesin një risk për punonjesit. Rreziqet domethenese janë incidentet me makinat lëvizëse, punime në lartësitë e shtyllave dhe ndikimi i zhurmave tek punetoret. Do të respektohen kërkesat kombetare të shendetit dhe sigurisë. Gjatë ndërtimit do të perdoren teknika dhe metoda miqesore ndaj trajtimit të mjedisit. Kjo pershkruhet e detajuar në Planin e Menaxhimit të Mjedisit.

2.6.11. Analiza e ndikimit të perkoheshëm në punimeve të germimit të tokës

Punimet e germimit do të shtrihet pjesërisht në një shesh toke jo të kultivuar me relief topografik kodrinoro-fushor, rrëzë disa rrugeve kryesore te zonës dhe pa probleme natyrore. Kthimi i terrenit të caktuar në sheshe për montimin e shtyllave, kërkon investime, dhe e parë në këndvështrimin ndaj mjedisit është një veprim që kryhet në të, por jo për ta keqësuar, por për ta përmirësuar dhe për ta vënë në shërbim të njeriut, jo vetëm për qëllime të ngushta përfitimi, por edhe në interes të zhvillimit publik. Montimi dhe rikonstruktimin i shtyllave të transmetimit të rrjetit elektrik nuk do të krijojë shqetësime për terrenet rreth e rrotull gjatë procesit të punimeve të montimit, pasi objekti nuk përfaqëson punime ndërtimi ose kompleks industrial. Gjatë kohës së montimit të shtyllave te reja nuk krijohen dëmtime të tokës, pasi nuk ka mbetje dëmtuese, që të shkarkohen në të, si në sipërfaqen në dispozicion, ashtu edhe përreth. Edhe në rast se ky aktivitet në një të ardhme, për arsye të ndryshme ndërpritet i gjithë sheshi është plotësisht i përdorshëm për çdo qëllim tjetër.

2.7 TË DHËNA PËR SHTRIRJEN E MUNDSHME HAPËSINORE TË NDIKIMIT NEGATIV NË MJEDIS

2.7.1 Distancën fizike nga vendndodhja e projektit

Distanca e ndikimit në mjedis nuk mund dhe nuk do të jetë jashtë territorit të zonës e cila do të jetë shtrirja e linjës së re sipas projektit.

2.7.2 Vlerat e ndikuara

Ky projekt në skemën e tij do të përmbajë elemente, që sigurojnë marrjen e masave në rast anomalie apo avarish, që mund të jenë deri në cënim të veprës. Hartimi i projektit të cekët apo me mangësi, zbatimi i punimeve me cilësi të dobët që bëhen burim avarish, janë shkaqet që sjellin pasoja të rënda në mjedis. Vec punonjësve që mund të preken nga pakujdesitë e punës dhe ndikimet e tyre nuk do të ketë ndikime të tjera jashtë këtyre ambienteve kjo edhe për shkak të rrethimit të kantierit ku do të punohet. Në rastet kur nuk është identifikuar asnjë masë zbutëse ose kur ndikimi nuk mund të zbutet siç duhet, VNM-ja ka trajtuar ndikimet e mbetura ose “reziduale”. Ndikimet reziduale shqyrtohen për secilin aspekt mjedisor dhe për nivelin e tyre të identifikimit.

| <i>Burimi i Ndikimeve</i> | <i>Objekti mbi të cilin bien</i> | <i>Lloji i ndikimit</i> |
|---|----------------------------------|--|
| Grumbullimit dhe transporti i mbetjeve. | ajër | - -, ndotje e ajrit nga grimca. |
| Rritja e intensitetit të transportit | Banorët vendas | - , rritja e nivelit të zhurmave dhe gjenerimi i dridhjeve në mjediset natyrore. |
| Ndotje akustike | punonjësit | - - , - shqetësim për punonjësit. |
| Zhvillimi i punimeve të ndertimit | Punonjësit, Banorët vendas | - -, Rritje të mundësisë për aksidente. |

Shpjegim :

- , Ndikim negativ i konsiderueshëm
- - , Ndikim negativ i lartë
- - - , Ndikim negativ shumë i lartë
- ? , Ndikim negativ që mund të mos ndodhë, por që duhet marrë në konsideratë.
- + , Ndikim pozitiv
- + + , Ndikim pozitiv i konsiderueshëm
- + + + , Ndikim pozitiv shumë i lartë.

Ky aktivitet kërkon një fokusim të gjerë për zbutjen e ndikimeve negative dhe rritjen e atyre pozitive gjatë aktivitetit të ndertimit të linjave të reja.

2.8 MUNDËSINË E REHABILITIMIT TË MJEDISIT TË NDIKUAR

2.8.1 Mundësinë e kthimit të mjedisit të ndikuar në gjëndjen e mëparshme

Rehabilitimi është procesi i zbulimit të ndryshimeve, nëse ato do të ndodhin, i përcaktimit të drejtimit dhe i matjes së shtrirjes të tyre. Objektivi themelor i kësaj çështje është që të ofrojë rekomandime të përshtatshme për rehabilitimin dhe njëherësh mbrojtjen e zonës, mbrojtjen e shëndetit të punonjësve, të mbrojtjes së cilësisë së ujrave sipërfaqësore dhe nëntokësore, si dhe të mbrojtjes së cilësisë së tokave në mënyrë që ai të shërbejë realisht për promocionin publik të gjithë zonës përreth. Mjedi i nuk modifikohet aq sa të mund të mos kthehet në gjendje të mëparshme, kështu mundësitë e kthimit në gjendje të mëparshme janë plotësisht të lehta dhe të riparueshme brenda pak ditëve. Masat dhe veprimet për sistemin dhe përgatitjen e vendit, për parandalimin e erozionit, për gjelbërimin, si dhe ndërhyrjet e vazhdueshme sigurojnë mirmbajtjen e habitatit.

2.8.2 Masat rehabilituese

Masat rehabilituese në planet e rehabilitimit identifikohen në përputhje me karakteristikat e vlerat e habitatit. Ato jepen të detajuara, duke u grupuar në:

- a) punime inxhinierike;
- b) punime biologjike.

Rigjelbërimi i habitatit me bimësi kryhet, duke i dhënë përparësi bimëve autoktone, të përshtatshme me zonën, që kanë ekzistuar montimit të linjës së re, si dhe bimësisë tjetër që është në përputhje me tipin e tokës. Llojet pyjore që përdoren për ripyllëzimin e sipërfaqes rreth dhe në brendësi të linjës rekomandohen, duke pasur parasysh:

- për mbrojtjen e tokave nga erozioni të përdoren llojet fletore përherë të blerta;
- për veshjen e terreneve të rreshqitshëm përdoren llojet pyjore të cilat kanë sistem rrënjor të fuqishëm, e mbajnë të mbuluar tokën edhe gjatë stinëve me rreshje të bollshme dhe e lidhin mirë atë;
- për terrene me shfaqje të erozionit duhet të përdoren dhe llojet që lidhin mirë terrenin dhe ndihmojnë parandalimin e erozionit;
- për terrene të eroduara, krahas fidanëve, të përdoret edhe mbjellja me farë.

Pyllëzimet e ripyllëzimet e terreneve të degraduara, pasi përfundojnë, i dorëzohen me dokumente të rregullta Drejtorisë së Shërbimit Pyjor, e cila i vë në ruajtje dhe i mbron për një periudhë 20-vjeçare për të bërë të mundur rimëkëmbjen e tyre. Kriteret për vlerësimin e rehabilitimit të habitatit të dëmtuar përfshijnë:

- a) zona e rehabilituar do të rikthehet në një gjendje të qëndrueshme dhe jo ndotëse;
- b) zona do të kthehet në gjendje të përshtatshme për përdorimin e mëtejshëm të planifikuar;
- c) zona do mbrohet nga erozioni;
- d) rigjelbërimi do të jetë efektiv në të gjithë sipërfaqen e habitatit, duke vlerësuar densitetin e fidanëve, larminë e llojeve dhe mbulesën bimore, siç është parashikuar në planin e miratuar të rehabilitimit.

Inspektorati i Mjedisit, në kontrollet që do të ushtrojë, do të ndjek zbatimin e planit të rehabilitimit, duke marrë masa e duke lënë detyra që garantojnë zbatimin e tij.

Pas mbarimit të të gjitha operacioneve rehabilituese, subjekti do të dorëzojë projektin e rehabilitimit ambjental të përfunduar në mënyrë të kënaqshme dhe në përputhje me kërkesat e planit të rehabilitimit.

Sistemimi dhe përgatitja e vendit

Hapi i parë në operacionin e rehabilitimit është pastrimi i përgjithshëm dhe sigurimi i zonës.

Masa të sugjeruara

Punimet e pastrimit të vendit që ndërmerren pas ndërprerjes së veprimtarisë përfshijnë:

- heqja dhe ndalimi i zhvillimit të veprimtarive që kanë karakter përpunimi (fraksionim guri) apo përgatitje betoni në afërsi të zonës;
- largimin e të gjitha pajisjeve të fiksuara dhe të palëvizshme, të përkohshme dhe të përhershme;
- largimi dhe eliminimi i duhur i të gjitha mbetjeve inerte;
- pas pastrimit të vendit mund të jetë i nevojshëm pengimi i hyrjes së njerëzve dhe kafshëve deri në rehabilitimin e zonës.

Hapi i parë në procesin e përgatitjes përfshin rimodelimin e zonës. Përdorimi përfundimtar i tokës do të përcaktojë formën e relievit. Vendi duhet të modelohet në mënyrë të tillë që të harmonizohet me peizazhin rrethues. Vendi duhet lënë në një gjendje të qëndrueshme, lehtësisht të kulluar që të harmonizohet me zonën rrethuese. Shtresa e tokës duhet të ripërhapet në mënyrë uniforme mbi zonë në një thellësi të përshtatshme për të mbështetur rigjëlberimin. Të gjitha zonat e ngjeshura duhet të punohen thellë përgjatë konturit. Kjo mund të kryhet përpara ose pas përhapjes së shtesës së dheut.

Rigjëlberimi dhe gjelbërimi

Vegetacioni është stabilizuesi më i mirë i mirëmbajtjes së thjeshtë të zonave të degraduara në periudhë afatgjatë. Gjelbërimi i shërben parandalimit të erozionit. Gjelbërimi gjithashtu minimizon ndikimin e ndërhyrjes pamore.

Masa të sugjeruara

- Gjelbërimi do të synojë instalimin e bimëve autoktone. Instalimi i tipeve të vegetacionit jo autokton, mund të kërkojë më shumë burime se riinstalimi i vegetacionit origjinal. Tokat për llojet e huaja duhet të jenë relativisht pjellore dhe mund të jenë të nevojshme trajtimet e mirëmbajtjes, si plehërimi dhe krasitja.
- Shtresa e materialit organik, me të cilin do të mbulohet sipërfaqja e tokës për të parandaluar erozionin rreth fidanëve që rriten, mund të reduktojë barërat e këqija dhe të ruajë lagështinë e tokës dhe shtimin e ushqyesve dhe lëndës organike të dobishme. Ndër materialet që mund të përdoren përfshijnë: komposto, mbetje druri, copëra, pluhura sharre, kashtë, levore etj.

Mbjellja - Në rastet më të shumta, gjelbërimi do të përfshijë ri futjen e llojeve të bimëve të përshtatshme për të plotësuar rigjenerimin me anë të erës ose farës së ruajtur në tokë. Kjo rifutje mund të jetë në formën e fidanëve të shtuar në fidanishte ose aplikimi i drejtpërdrejtë të farës në shtratin e farës të përgatitur.

Monitorimi dhe mirëmbajtja - Rehabilitimi është një proces që mund të shkojë me vite për të dhënë një ekosistem të qëndrueshëm dhe vetë qëndrues. Kujdesi i mëpastajshëm është vitalisht i rëndësishëm dhe çdo dështim duhet të riparohet shpejt.

Masa të sugjeruara

Zonat e rehabilituara do të inspektohen rregullisht për të vlerësuar shëndetin e vegjetacionit dhe kontrolluar për erozion, dëmtim dhe ndotje nga barërat e këqija. Inspektime të përvitshme mund të kërkohen në disa zona më të mëdha pas ndërprerjes së operacioneve për të siguruar suksesin në vazhdim të gjelbërimit.

2.8.3. Masat për të ruajtur ekuilibrin mjedisor:

- Hapjen dhe pastrimin (mirëmbajtjen) e kanaleve kolektorë, gjatë gjithë gjatësisë përreth gropave për moslejimin e hyrjes së rrjedhjeve ujore e të mbatjeve të ngurta në territorin përreth dhe daljen prej tyre drejtpërsëdrejti në rrjedhjen e ujrave sipërfaqësore.
- Respektimin e formave të relievit ekzistues në zonat përreth.
- Ngjeshja e tokës pas perfundimit të germimit të gropave.
- Mbushja e dyshemes së gropave me një shtresë me një shtresë zhavori me $h = 0.30$ m;
- Zbatimi me rigorozitet rregullorja e sigurimit dhe shfrytëzimit teknik;
- Kthimi në gjendjen e mepareshme të vendeve ku kryehen punimet, pas perfundimit të tyre.

2.8.4. Kostot financiare të përafërta për rehabilitim

Ndikimet negativë të parashikuar nga punimet e ndërtimit të linjës mund të minimizohen, duke u shoqëruar me një kosto paraprake për masat zbutëse. Masat zbutëse për fazat operuese përmbledhen në tabelat e mëposhtme. Këto tabela identifikojnë masat zvogëluese, që duhet të zbatohen për të minimizuar efektet e parashikuar për çdo veprimtari. Të gjithë aspektet e planit zbutës përfshihen në praktikën e mira të inxhinierisë dhe praktikën më të mira të menaxhimit dhe si rezultat është e përfshirë në kostot aktuale të projektit.

| Aktiviteti | Efektet potenciale | Plani i zvogëlimit | Përgjegjësia | Kostoja e përafërt |
|--|--|---|-----------------|--------------------|
| Vendi i punësi pastër dhe shkallëzimi | Mungesë pemësh | Pemët nuk do të preken nga vendi i punës. Asnjë pemë që nuk ka lidhje me vendin e punës, nuk do të pritet. Pemët që do të priten do të bëhen të disponueshme për banorët e zonës. | Komp Kontraktor | \$400 |
| Vendi i punës i pastër dhe shkallëzimi | Ndërhyrja në dranzhimin e vendit dhe të erozionit të tokës | Shkallëzimi final i vendit do të lehtësojë dhe do të shmang përmbytjet dhe pellgjet. Një plan dranzhimi i vendit do të bëhet për mbrojtjen nga erozioni. Vendosja e tabelave sinjalizuese dhe rrethimi me rrjet do të minimizoj ndotjen e ajrit gjatë ndërtimit. | Komp Kontraktor | \$1000 |
| Vendi i punësi pastër dhe shkallëzimi | Zhurma nga paisjet | Paisjet e ndërtimit duhet të jenë sipas direktivave standarte të Komunitetit Europian 2000/14/EC të maj 2000. Kjo Direktive aplikohet tek prodhuesit e paisjeve, që bëjnë zhurma. Zhurma gjatë punës duhet të minimizohet gjatë kohës së pushimit. Të gjitha paisjet duhet të mbahen në kushte të mira. | Komp Kontraktor | Të vogla |
| Përmirësimi i vendit të punës dhe të rrugëve | Pluhuri | Vaditja e sipërfaqeve të vendit të punës, ashtu siç nevojitet do të minimizojë pluhurin. Të gjitha paisjet duhet të mbahen në kushte shumë të mira. | Komp Kontraktor | \$500 |
| Kullimi | Ndotja nga mbetjet | Atje ku germimet kërkojnë kullimin. Uji i tepërt duhet inspektohet për përmbajtje ndotëse përpara derdhjes në sistemin e kullimit. | Komp Kontraktor | \$500 |
| Vendndodhja e territorit të ndërtimit | Konfliktet me përdoruesin aktual të tokës | Zona e ndërtimit nuk është sipërfaqe bujqësore, por prone e OST | Komp | Të vogla |
| Vendndodhja e territorit të ndërtimit | Problemet me komunitetin | Të gjitha lejet dhe aprovimet do të merren nga autoritetet e duhura përpara operimit në vend. | Komp Kontraktor | \$2,000 |
| Vendndodhja e territorit të | Sipërfaqet e zëna më | Sipërfaqja e ndërtimit do të ripunohet për tu përzier me ambientin përreth. Ribimësia duhet të kryet në përputhje me | Komp | \$4,000 |

| | | | | |
|---|---|---|-----------------|----------|
| ndërtimit | aktivitet | bimësinë lokale. Të gjitha vendet e punës do të kthehen në kushte të qëndrueshme. | Kontraktor | |
| Caktimi i vendit për materialet e gërmuara në esh-të e nevojshme. | Ndërhyrja në kullimet natyrale | Shuma e materialeve të predispozuara duhet të minimizohen nga marrja vetëm atë që duhet. | Komp Kontraktor | Të vogla |
| Caktimi i vendit për materialet e gërmuara në eshtë e nevojshme. | Shqetësimet me tokën | Autoritetet lokale duhet të aprovojnë vendodhjen e caktuar. Ajo nuk duhet të ndërhyjë me tokën lokale në përdorim. Bimësia duhet të kryhet në përputhje me bimësinë lokale. Të gjitha pjerrësitë dhe vendet e punës të kthehen në kushte të qëndrueshme. | Komp Kontraktor | \$2,000 |
| Ndërlidhja e sistemit të transmetimit | Shqetësimet me tokën. | Asnjë tokë bujqësore nuk preket nga ndërtimi i shtyllave. | Komp Kontraktor | Të vogla |
| Burimet e mbulimit të gropave | Zvogëlimi i burimeve lokale | Nuk do të ketë burime të tjera. Do të përdoren dherat e gërmuara për mbulimin e gropave që do krijohen gjatë punimeve të ndërtimit. | Komp Kontraktor | Të vogla |
| Forca ndërtuese | Fluksi i punëtorëve që krijojnë presion në shtëpitë dhe burimeve të tjera | Fluksi i të punësuarve nuk do të kalojë 10-20 persona. Punëtorët duhet të jenë banorë të zonës përreth dhe do të sillen me autobus në vepër. Një qendër e ndihmës së shpejtë do të sigurohet për punëtorët në vepër. | Komp Kontraktor | \$1,000 |
| Shpërndarja e paisjeve dhe e materialeve | Rritja e trafikut dhe e pluhurit | Pluhuri do të minimizohet me vaditjen e shesheve të punimeve gjatë ndërtimit të magazinës. Shpejtësia në rrugë duhet të kontrollohet për të zvogëluar rrezikun e aksidenteve. | Komp Kontraktor | \$1,000 |
| Vend të caktuar për mbeturinat solide | Problemet potenciale të shëndetit | Mbeturinat solide duhet të hiqen nga një kontraktor i licencuar. | Komp Kontraktor | \$2,000 |
| Vend të caktuar për mbeturinat e lëngëta | Ndotja potenciale e ujit | Nuk do të lejohet shkarkesë direkte e ujërave të mbetur por do të shtohet një degëzim dhe do të lidhet me magjistralin kryesor. | Komp Kontraktor | \$1,000 |
| Gërmimi i gropave të kabinave dhe i derdhjeve ujore | Problemet e burimeve ujore | Mbeturinat nga ndërtimi nuk do të hidhen në vend e pavend. | Komp Kontraktor | \$1,000 |
| Vendndodhja finale | Estetika | Tokat do të gjelbërohen në mënyrën më të përshtatshme. | Komp Kontraktor | \$1,000 |

2.9 MASAT E MUNDSHME PËR SHMANGIEN

2.9.1 Masat zbutëse e ndikimeve negative në mjedis

Ndikimet negative kërkojnë hartimin e masave zbutëse dhe rikuperimet për ndikimet negative dhe kjo realizohet me anë të tre metodave të mundshme:

- *Evitimi* ose parandalimi i ndikimit;
- *reduktimi* ose korigjimi i ndikimit; dhe
- *kompensimi* ose shlyerja e ndikimit.

Lloji i rekomanduar i zbutjes së ndikimit ka mundësi të varet nga një sërë faktorësh, përfshirë zbatueshmërinë teknike, praktikitetin, resurset dhe kapacitetin e disponueshëm, koston dhe nëse rikuperimi i propozuar është konsistent me planin ose programin e propozuar.

2.9.2 Metodat e mundshme për zvogëlimin e ndikimeve negative në mjedis

Evitimi ose parandalimi

Parandalimi i ndikimeve negative është opsioni i parë dhe më i miri, në rast se është në linjë me qëllimet e tjera të programit të propozuar. Parandalimi funksionon më mirë kur zbatohet herët në procesin e vendimmarrjes dhe në një nivel strategjik. Sapo janë marrë vendimet kryesore në lidhje me një program të propozuar (psh në rastin e zhvillimit të tokës – shkalla e zhvillimit, vendndodhja dhe lloji i përdorimit i propozuar), rikuperimi ka më shumë mundësi të fokusohet në reduktimin ose shmangien e ndikimeve.

2.9.3. Reduktimi ose korigjimi

Reduktimi i ndikimeve negative ka mundësi të jetë metoda më e zakonshme. Dëmtimi në mjedis mund të jetë i pranueshëm, por kur mbahet brenda kufijve të pranueshëm. Korigjimi i ndikimeve negative është i ngjashëm me reduktimin, përveçse kryhet pasi kanë ndodhur ndikimet, për shembull rimbjellja e vegetacionit të dëmtuar. Masat për shmangien e efekteve negative janë në 3 drejtime:

- Me karakter teknik
- Me karakter organizativ
- Kontrolli dhe monitorimi në kohë

Kompensimi ose shlyerja

Kompensimi ose shlyerja e ndikimeve përfshin krijimin e një përfitimi mjedisor i cili kompenzon për një dëmtim tjetër mjedisor. Vështirësia e kompensimit qëndron në sigurinë që do të kryhet.

2.9.4. Vlerësimi i masave për Zbutjen e ndikimeve negative në mjedis

Në rastet kur ndikimi nuk mund të zbutet siç duhet, VNM-ja ka trajtuar ndikimet e mbetura ose “reziduale”. Ndikimet reziduale shqyrtohen për secilin aspekt mjedisor dhe për nivelin e tyre të identifikimit. Një përmbledhje e ndikimeve të identifikuara të projektit dhe e mjeteve zbutëse dhe menaxhuese jepet në këtë tabelë:

Tabela e Identifikimit të ndikimeve dhe masat zbutëse

| Zona e ndikimit | Çështjet kryesore | Rëndësia | Masat zbutëse kryesore |
|------------------------------|--|---|--|
| Klima | ▪ Asnjë çështje e rëndësishme e identifikuar | ▪ E papërfillshme | ▪ Plan i parandalimit të ndotjeve |
| Cilësia e ajrit | ▪ Çlirimet prej menaxhimit të mbetjeve Aksi 1 | ▪ E papërfillshme | ▪ Plan i kontrollit të cilësisë së ajrit |
| Zhurmat & Dridhjet | ▪ Rritja e nivelit të zhurmave në repartet e Aksi 1 | ▪ E papërfillshme | ▪ Plan i kontrollit të zhurmës dhe dridhjeve |
| Hidrologjia & Resurset ujore | ▪ Shfrytëzimi i ujrave të pijshëm dhe industrial | ▪ E vogël, e pafavorshme | ▪ Plan i menaxhimit të ujërave ▪ Plan i kontrollit të derdhjeve |
| Bota bimore dhe shtazore | ▪ Shfarosja e habitateve në zonën e Aksi 1 | ▪ E papërfillshme | ▪ Plani i mbrojtjes së habitateve, botës bimore dhe shtazore ▪ Plan i menaxhimit të sipërfaqes së gjelbër |
| Trashëgimi kulturore | ▪ Asnjë sit i njohur arkeologjik brenda zonës | ▪ E papërfillshme | ▪ Politikat e “zbulimeve të vona” |
| Trafiku & Transporti | ▪ Aksidentet rrugore | ▪ E papërfillshme | ▪ Plan i urgjencës |
| Pamor | ▪ Pamja e ambjenteve të magazinës të mbetjeve të rrezikshme | ▪ E përfillshme ▪ E vogël, e pafavorshme | ▪ Plan i rehabilitimit dhe përmbylljes ▪ Plan i menaxhimit të mbetjeve |
| Social-ekonomik | ▪ Punësim lokal dhe rajonal ▪ Rikthim i krahut të punës në zonë | ▪ E moderuar, e favorshme | ▪ Plan i lidhjeve me komunitetin ▪ Plan i burimeve njerëzore |

Ndikimet negative të parashikuar nga vepra mund të minimizohen. Ky seksion diskuton masat zvogëluese për ndikimet negativë nga punimet për rehabilitim. Masat zbutëse për fazat operuese përmbledhen në tabelat e mëposhtme. Këto tabela identifikojnë masat zvogëluese, që duhet të zbatohen për të minimizuar efektet e parashikuar për çdo veprimtari. Të gjithë aspektet e planit zbutës përfshihen në praktikat më të mira të inxhinierisë dhe praktikat më të mira të menaxhimit dhe si rezultat është përfshirë në kostot aktuale të projektit. Masat për uljen e kontrollin e çlirimeve gjatë fazës së operimit janë përshkruar në tabelën e mëposhtme. Këto përfshijnë:

- Minimizimin e ngarkesës
- Rikuperimin
- Pakësimin e çlirimeve
- Trajtimin dhe largimin e mbeturinave.

Pas identifikimit të ndikimeve kryesore në shoshitjen e ndikimeve trajtohen madhësitë e këtyre ndikimeve për të arritur të jepet një pasqyrë sa më e qartë e mundësive dhe mënyrave të zbutjes së ndikimeve negative kryesore dhe e rritjes sa më të mundshme të atyre pozitive.

2.9.5. Masat e shmangies së ndotjes së ajrit

Ndotja mund të vijë, si nga pluhuri që krijohet nga punimet e ndërtimit të përkohshëm në gropën e gërmuar që do të montohen shtyllat e linjës, si dhe nga rritja e lëvizjes së mjeteve të motorizuara dhe të rënda. Masat për uljen e nivelit të pluhurave të gjeneruara nga transporti apo depozitimi janë në mirëmbajtjen e cilësisë së vendit të punës, si dhe rrethimin me rrjeta të dendura dhe me veshje të kostumeve mbrojtëse të punonjësve të kantierit të ndërtimit në ambientet e punës. Por këtu duhet të theksohet se ky tip ndotje është shumë i kufizuar, pasi ndodh vetëm në periudhën kohore të

gërmimit të bazamentit të themeleve të shtyllave. Masat e shmangies së ndotjes së ajrit janë si më poshtë:

- Ulja e nivelit të ndotjes së ajrit nga pluhurat prej shtimit të transportit mund të realizohet me larjen e makinave të objektit;
- Rrugët ndihmëse të kantierit do të trajtohen vazhdimisht me ujë, përpara se të kalojnë mjetet e transportit, duke evituar kështu gjenerimin e pluhurave nga sipërfaqet më të largëta, por në lartësi relative të madhe;
- Spërkatja me ujë gjatë hapjes së gropave për bazament të shtyllave gjatë gjithë ditës për të mos ndikuar në prodhimin e pluhurave ashtu siç ndodh rëndomë gjatë kryerjes së punimeve të ndryshme nëpër rrugët.

2.9.6. Masat e uljes së ndikimeve negative të zhurmane

Masat zbutëse kundër zhurmane duke përdorur mjete transporti dhe pajisjesh ndertimi me nivel të ulet zhurme.

2.9.7. Masat e shmangies së ndotjes së ujrave sipërfaqësore

Eksperiencia e deritanishme ka treguar se linja ekzistuese nuk ka qenë shqetësim për ndotjen e ujrave sipërfaqësore përreth zonës, sepse në montimin e kësaj linje të re nuk do të kryhet aktiviteti prodhimi me emetime në ajër dhe shkarkime në ujra sipërfaqësore. Ujrat e përdorura për sperkatjen e ambienteve do të grumbullohen dhe do të derdhen në kanalizimet e ujrave të bardha në kanalën magjistral.

2.9.8. Masat e shmangies së ndikimeve në intensitetin e erozionit

Masat zbutëse kundër erozionit janë të dy niveleve kryesore, si masa hidroteknike dhe ajo biologjike, duke realizuar që pjesa e sipërme e terrenit do mbrohet nga rreshqitja me si më poshtë.

- me mur të thatë guri
- blloqe betoni

Nivelimi i sheshit të shtyllës do minimizohet sidomos në terrenet e pjerta.

Bordura e poshtme e terrenit të shtyllës, në terrenet e pjerreta do forcohet.

Pasi të perfundojë monitimi i shtyllave elektrike, rruget hyrese do kthehen në gjendjen fillestare.

Ulluqet dhe rrepirat do zhduken, demtimet e kanaleve, tarracave, rrugëve dhe veçorite të tjera të tokës do korrigjohen, dhe toka do kthehet në kushtet e saj të mëparshme.

Rruget hyrese do të ecin gjithmone poshtë nivelit të shtyllave për të zvogeluar impaktin eroziv.

Me qëllim që të sigurohet shmangia e demtimit të tokave, do të ndërtohen kanale drenazhimi për kullimin e shirave dhe do të inspektohet në bazë javore në stinën e reshjeve.

2.9.9. Masat në mbrojtjen nga aksidentet në punë

Punonjësit duhet të pajisen me veshje pune dhe të trajnuar në shërbimin e këtij aktiviteti. Brigada e punonjësve që do të bëjë gërmimin e bazamenteve dhe montimin e shtyllave, duhet të disponojnë dokumenta, ku pasqyrohet puna me punonjësit për njohjen dhe zbatimin e rregullave, e cila do të bëhet e përjavëshme dhe e dokumentuar me firmat përkatëse për njohuritë bazë në zbatimin e rregullave të sigurimit teknik.

1. Para së gjithash me marrjen në dorëzim të të gjithë dokumentacionit teknik e administrativ, Shoqëria "OST" sh.a. do të marrë të gjitha masat e organizimit në drejtim të plotësisimit me rigorozitet të rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes në punë.
2. Për këtë në kantierin e ndërtimit do të vihen shenja dalluese, të cilat bëjnë të qartë se këtu
3. kemi të bëjmë me kantier ndërtimi, për çdo të huaj. Në hyrje të kantierit të ndërtimit

vendoset tabela dalluese e shoqërisë.

4. Gjatë kryerjes së aktivitetit të punimeve të ndërtimit do të zbatohet me përpikmëri rregullorja e sigurimit teknik në kantier.
5. Para fillimit të punës duhet të kontrollohet fronti i punës në çdo post pune, kontrolli i gjendjes dhe gadishmërisë së mjeteteve dhe makinerive.
6. Në objekt do të vendosen tabelat e sigurimit teknik që kufizojnë punonjësit apo të huaj për kalimin me vend e pa vend, rrugët e detyrueshme të kalimit për ruajtjen nga ndonjë aksident i mundshëm gjatë veprimtarisë operationale.
7. Punimet e ndërtimit do drejtohen nga një specialist i fushës.
8. Punonjësit duhet të pajisen me veshje pune gjatë orarit të punës.

Në objekt do të regjistrohen dokumenta, ku do pasqyrohet puna me punonjësit për njohjen dhe zbatimin e rregullave, e cila do të bëhet e përjavshme dhe e dokumentuar me firmat përkatëse për njohuritë bazë në zbatimin e rregullave të sigurimit teknik.

2.9.10. Masat në ruajtjen e ekuilibrit mjedisor:

- Hapjen dhe pastrimin (mirëmbajtjen) e kanaleve kolektorë, gjatë gjithë gjatësisë përreth (anash shesheve të kabines shtyllore) për moslejimin e hyrjes së rrjedhjeve ujore e të mbatjeve të ngurta në territorin përreth shtyllave dhe daljen prej tyre drejtpërsëdrejti në rrjedhjen e ujrave sipërfaqësore. Thellësia e kanalit të shkarkimit të ujrave plotëson kushtet e projektit dhe tendenca e tij është në funksion të topografisë së zonës.
- Respektimin e formave të relievit ekzistues në zonat përreth.
- Ngjeshja e tokës pas perfundimit të germimit të gropave.
- Mbushja e dyshemes së gropave me një shtresë zhavori me $h = 1.60$ m.
- Ndertimi i një sistem drenazhimi përreth gropes në tokat ujembajtëse.
- Zbatimi me rigorozitet rregullorja e sigurimit dhe shfrytëzimit teknik
- Kthimi në gjendjen e me pareshme të vendeve ku do kryehen punimet, pas perfundimit të tyre.

2.9.11. Përdorimi i praktikave më të mira të ndërtimit dhe menaxhimit

Përdorimi i pajisjeve të përshtatshme, përshtatja me rregulloret ndërkombëtare dhe zbatimi sipas standarteve dhe teknikave më të mira të ndërtimit, janë një kërkesë thelbësore për zgjedhjen e kontraktorëve dhe plotësimin e suksesshëm të projektit. Kjo do të sjellë përfitime të dukshme për zbutjen e ndikimit të ndërtimeve në mjedis.

2.9.12. Masat social-ekonomike

Zvogëlimi i ndikimeve social ekonomike nga projekti i ndërtimit të linjës së re përfshin përpjekjet për shmangien e keqkuptimeve për punësim afatgjatë të punëtorëve lokalë, edukimin e popullatës mbi natyrën jo spekulative të funksionimit të projektit në fjalë, duke patur parasysh kompesimin si dhe trajtimin me respekt të banorëve të zonës. Operatori, ka bërë dhe po vazhdon të bëjë një punë të planifikuar dhe të kujdesshme, ku operon kjo linjë elektrike. Për çdo të papritur që mund të ndodh gjatë zbatimit të projektit, operatori ka marrë masa të lajmërojnë autoritetet e pushtetit vendor dhe të veprojë në përputhje me ligjin Shqiptar në fuqi.

2.9.13. Plani i menaxhimit të ambientit

Çdo veprimtari e rëndësishme që kryhet në marëdhënie me mjedisin, duhet të parashikojë në projektin e saj edhe Planin e Menaxhimit të Mjedisit (PNM), qëllimi i të cilit është parandalimi, minimizimi dhe mënjanimi i ndikimeve negative ndaj mjedisit të veprimtarisë që propozohet të kryhet. Duhet theksuar që Plani i menaxhimit të mjedisit është në interes të të gjithëve kundrejt plotësimit të kërkesave. Plani i menaxhimit të ambientit do të përqëndrohet dhe fokusohet në

mënyrë që të garantohen kushte normale të kryerjes së punimeve gjatë fazës së punimeve të ndërtimit, si edhe të krijimit të ambienteve të shërbimit dhe punës sipas standarteve bashkohore duke shtuar sigurinë e kushteve të punës së punonjësve dhe shmangien e aksidenteve në ambientet ku punohet, dhe shqetësimin e banorëve të kesaj zone.

2.9.14. Plani i pjesëmarrjes per konsultimin publik dhe prezantimi i planit

Operatori do të drejtojë veprimtarinë e pjesëmarrjes publike në përputhje me legjislacionin Shqiptar në fuqi. Ai do të përgatisë një listë të urdhëresave të qeverisë lokale, të cilat do të informohen mbi planet e ecurisë dhe konkluzionet e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis dhe institucionin qëndror (Ministrinë e Mjedisit). Ai do të organizojë edhe një mbledhje me pjesëmarrjen publike të ambientalistëve rajonalë dhe të njerëzve që janë të ndjeshëm ndaj problemeve të mjedisit. Stafi i tij duhet të ndërgjegjësojë opinonin publik mbi llojin e projektit, kohëzgjatjen e tij, masat që ka planifikuar të marrë për zbutjen e ndikimeve negative të mundshme, shpërblimin në rast dëmtimesh të pronarëve, mundësinë e punësimit vendor, pra, gjithçka që do të bëhet, do të ketë për bazë respektimin në maksimumin e mundshëm të mjedisit.



2.10 NDIKIMET E MUNDSHME NË MJEDISIN NDËRKUFITAR

Mjedisi ndërkufitar nuk përfshihet në teritorin e këtij projekti ndaj nuk do të ketë.



III. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

3.1. PËRFUNDIME

1. Procesi i vlerësimit të ndikimit në mjedis bazohet në Legjislacionin shqiptar dhe atë ndërkombëtar
2. Procesi i vlerësimit të ndikimit në mjedis siguron një përmbledhje të informacionit të disponueshëm në përputhje me kushtet e vend-ndodhjes së aktivitetit,
3. Procesi i vlerësimit të ndikimit në mjedis paraqet masa lehtësuese për të minimizuar ose për të ndaluar ndikimet sociale dhe mjedisore të projektit. Këto përfshihen në një Plan Menaxhimi Ambiental (PMA),
4. VNM përfshin parashikimin dhe planifikimin e masave zbutëse të ndikimeve të projektit në mjedisin fizik dhe social.
5. VNM është një proces që zhvillohet brenda procesit të planifikimit dhe zbatimit të projektit.
6. Qëllimi i VNM nuk është të pengojë zhvillimin ekonomik dhe as të ruajë të pashqetësuar ekosistemet natyrore, por të balancojë faktorët ekonomikë, teknikë dhe ambienta me kostot përkatëse, si dhe të përmirësojë cilësinë e planifikimit dhe të zhvillimit.
7. Ky raport synon, analizimin e faktorëve pozitivë e negativë mjedisore, dhënien e masave zbutëse, si për reduktimin e ndikimeve negative, si dhe tenton për përmirësimin e vlerave ekologjike e rikrijuese të territorit pas ndikimit të mundshëm në mjedis të punimeve të ndertimit.
8. Ligji Nr. 10440 dt. 07.07.2011 "Mbi vlerësimin e impaktit në mjedis" synon një vlerësim të përgjithshëm, të integruar dhe kohor të impaktit në mjedis të projekteve dhe veprimtarive që zbatohen, duke parandaluar dhe/ose kufizuar impaktin negativ në mjedis; një proces të hapur vlerësimi, të kryer në mënyrë të pa anëshme ndërmjet pjesëmarrjes së organeve qendrore dhe vendore, antarëve të publikut, organizatave jo fitimprurëse, sponsorëve të projektit dhe personave të specializuar në këtë fushë.
9. Kushtet klimatike mesdhetare dhe kushtet e veçanta ujore të këtij ekosistemi kanë përcaktuar një mbulesë bimore dhe një botë shtazore të larmishme. Bimësia dallohet për periudhën e gjatë të vegjetacionit mbi 10 muaj.
10. Nga pikëpamja hidrogeologjike, rajoni bën pjesë në pellgun e madh artezian të Ultësirës Perëndimore, i cili është i pasur me ujra nëntokësore. Kjo është e kushtëzuar nga përhapja e shkëmbinjve me veti të mira dhe mesatare kolektore (zhavorre dhe konglomeratë), nga kushtet e favorshme klimatike me reshje rreth 1100 mm/vit, nga një rrjet i dendur hidrografik dhe me reliev fushor me pjerrësi të vogël drejt perëndimit.
11. Temperatura mesatare vjetore e ajrit është 15.9°C, duke patur një variacion mujor që ndryshon nga temperatura 7.0°C në janar, që është edhe muaji më i ftohtë i vitit deri në 23.0°C në korrik që është muaji më i nxehtë.
12. Ndryshimet për një periudhë shumëvjeçare variojnë brenda kufijve të gjerë, përkatësisht nga 19.5 10⁹m³ për vitin e thatë (P=99%) në 73.10⁹m³ për atë të lagët (P=1%). Ka dy periudha karakteristike, përse i përket rrjedhjes ujore: periudha e lagët (tetor – maj) dhe periudha e thatë (qershor - shtator). Përkatësisht, shpërndarja është si më poshtë 39% i përket dimrit, 33% pranverës, 17% vjeshtës dhe 11% verës.
13. Edhe pse është e paevitueshme, që në rajon të shfaqen disa ndikime negative mjedisore e sociale, projekti do të bëjë që të ketë punësim të vazhdueshëm; të sigurojë investime të drejtpërdrejta në komunitetin lokal; të krijojë të ardhura të konsiderueshme financiare dhe

- ekonomike në zonë e në në rajonin në tërësi; ndikimet mjedisore që janë identifikuar të eliminohen, reduktohen ose zbuten nëpërmjet zbatimit të planit të menaxhimit të mjedisit.
14. Sipas studimit të deritanishëm, nuk është identifikuar asnjë "ndikim fatal", ndonëse ekzistojnë disa ndikime të vogla negative, të cilat do të kontrollohen nga masat zbutëse inxhinierike dhe nga ato të lidhura me gërmimin e bazamentin e shtyllave.
 15. Operatori do të përgatis planet e caktuar të sigurisë, që duhet të përfshijnë: Proçedurat e sigurimit në punë apo rregullat e sigurimit teknik; Proçedurat e ndihmës së shpejtë në raste aksidentesh në punë; Proçedurat e nënshtirmit apo të fikjes së zjarrit.
 16. Në këtë veprimtari që kryhet në marëdhënie me mjedisin, është parashikuar në projektin e saj edhe Planin e Menaxhimit të Mjedisit (PNM), qëllimi i të cilit është parandalimi, minimizimi dhe mënjanimi i ndikimeve negative ndaj mjedisit të veprimtarisë që propozohet të kryhet.
 17. Shërbimi në kete montim dhe rikonstruksion të shtyllave elektrike mendohet se nuk ka ndikime të mëdha, jo vetëm nga pikëpamja e efekteve momentale, por edhe për jetëgjatësinë e tij.
 18. Vendet ku kryehen punime, pas perfundimit te tyre do te kthehen ne gjendjen e me paireshme.
 19. Gjatë kohës së montimit të shtyllave nuk krijohen dëmtime të tokës, pasi nuk ka mbetje dëmtuese që të shkarkohen në të, si në sipërfaqen në dispozicion, ashtu edhe përreth.
 20. Numri i mjeteve të transportit do të jetë i ulët dhe për rrjedhojë ato nuk do të krijojnë ndikim të ndjeshëm negativ. Përsa i përket përhapjes së pluhurit nga rrugët dhe sheshi i ndërtimit mund të eliminohen apo minimzohen duke aplikuar masat e duhura zbutëse, efektet e të cilave janë vlerësuar në bazë të vlerave të raportuara në tabelat pëkatëse.
 21. Përfundimisht, ky aktivitet i montimit të shtyllave dhe linjes ajrore 110kV për perballimin e ngarkesave, si dhe për permiresimin e furnizimit me energji, plotëson kushtet mjedisore, natyrisht duke marrë masat plotësuese nga ana e kësaj kompanie për eliminimin e rreziqeve sado të vogla qofshin ato.

3.2 REKOMANDIME

1. Të rifreskohen e të shtohen tabelat dhe sinjalizimet, për të parandaluar aksidentet në punë, aksidentet automobilistike si edhe zjarrin. Është shumë e nevojshme që të kryhet edhe trajnimi i punonjësve për sigurimin teknik në kushtet e një linje elektrike;
2. Këto diapazone duhen të merren parasysh në mënyre të tillë që perioda e vibrimeve vetiake të objektit që do të ndërtohet të jetë shumë e ndryshme prej tyre;
3. Të mënjanohen ujërat sipërfaqësorë.
4. T'i kushtohet kujdes cilësisë së punimeve të ndërtimit.
5. Të kryhet trajnimi që do të mbulojë kushtet ekzistuese të mjedisit, ndikimet potenciale në mjedis nga projekti i ndërtimit, implementimin e masave lehtësuese specifike në minimizimin ose eliminimin e ndikimeve negative, dhe masat e përgjithshme mbrojtëse për mjedisin.
6. Investitori të jetë i kujdeshëm në këqyrjen dhe marrjen e masave pararendëse, si në ndryshimin e nivelit të ujërave nëntokësorë, sjelljen dhe reagimin e kafshëve, fryrjen e pjerrësive, fryrjen e sipërfaqeve, etj.

IV. STUDIME MBËSHTETËSE

RAPORTE VLERËSIMI TE NDIKIMIT NË MJEDIS – VNM

| Nr. | RAPORTI | AFATI | AUTORI | POROSITËSI |
|-----|--|-------------|--------|---------------------------------|
| 1. | Raport VNM nënstacionit elektrik Bradashesh (Elbasan), nënstacionin Sukth, Vlorë, nënstacionin Babicë. | Maj 2005 | G & G | KESH |
| 2. | Raport i Vlerësim të Ndikimit në Mjedis - VNM Fark | Mars 06 | G & G | Komuna Fark |
| 3. | Raport i Vlerësim të Ndikimit në Mjedis - VNM për zhvillim të zonës urbane Kashar | Mars 06 | G & G | Komuna Kashar |
| 4. | Raport i Vlerësim të Ndikimit në Mjedis - VNM për zhvillim të zonës urbane Dajt | Maj 06 | G & G | |
| 5. | Raport i Vlerësim të Ndikimit në Mjedis - VNM ish kimike | Gusht 2006 | G & G | Komp. Planet |
| 6. | Studim Riciklimi Plastikës në Shqipëri | Nëntor 2006 | G & G | MMPAU |
| 7. | Studime Shëngjin | Dhjetor 06 | G & G | MMPAU |
| 8. | Raport i Vlerësim të Ndikimit në Mjedis - VNM Vlush | Shkurt 07 | G & G | Ko.AlbaConstr. tiran |
| 9. | Raport i Vlerësim të Ndikimit në Mjedis - VNM Miniera Hekur nikel, Bitincke | Mars 07 | G & G | Komp Angleze |
| 10. | Raport i Vlerësim të Ndikimit në Mjedis - VNM NGA SHFRYTËZIMI I MUNDSHËM I UJËRAVE TË LUMIT DEVOLL PËR HEC NË MENKULAS, BILISHT | Mars 07 | G & G | Komp. Alba Construction, Tiranë |
| 11. | Raport i Vlerësim të Ndikimit në Mjedis - VNM Arsenik, Fier | Prill 07 | G & G | Ko. Plan Center, Finland |
| 12. | Raport i Vlerësim të Ndikimit në Mjedis - VNM HEC, Menkulas | Prill 07 | G & G | Komp. Alb Constr. Tiranë |
| 13. | Raport i Vlerësim të Ndikimit në Mjedis - VNM Fshat Turistik, Velipojë | Maj 07 | G & G | Komp Amerikane |
| 14. | Raport i Vlerësim të Ndikimit në Mjedis - VNM HEC, Vlushë | Maj 07 | G & G | Ko.AlbaConstrTiranë |
| 15. | Raport i Vlerësim të Ndikimit në Mjedis - VNM HEC, i ujërave të Përroit Lenies-Shalësit-Strelçës për hec në zonë e Strelçës, Korçë | Maj 07 | G & G | Xh. Ngjeqari |
| 16. | Raport i Vlerësim të Ndikimit në Mjedis - VNM HEC, nga shfrytëzimi i mundshëm i ujërave të lumit t vlushës, Skrapar | Maj 07 | G & G | Xh. Ngjeqari |
| 17. | Raport i Vlerësim të Ndikimit në Mjedis - VNM HEC, mbi rrjedhjen e sipërme të lumit Mat (Hidro/centrali i Stavecit) | Maj 07 | G & G | Xh. Ngjeqari |
| 18. | Vlerësimi i ndikimit në mjedis i zonës së peshkimit në lagunën e spiakhos, divjakë | Qershor 07 | G & G | Kompani Peshkimi, Divjakë |
| 19. | Vlerësim i Ndikimit në Mjedis Aeroportit Civil Korçë | Shtator 07 | G & G | Instituti Urban, Tiranë |
| 20. | Vlerësim i Ndikimit Në Mjedis i rrugës nacionale superstradë Thumanë – Rrogozhinë | Nëntor 07 | G & G | Instituti Kroat |
| 21. | Vlerësim i Ndikimit në Mjedis i rrugës nacionale superstradë Tiranë Dibër | Dhjetor 07 | G & G | Komp. MEGALBA, Maqedoni |
| 22. | Vlerësim i Ndikimit Në Mjedis i rrugës nacionale superstradë Durrës – Tiranë - Elbasan | Gusht 08 | G & G | Komp. Strabak, Vjenë |
| 23. | Vlerësim i Ndikimit në Mjedis i zonës Nartë - Novoselë për zhvillim | Gusht 08 | G & G | Qarku Vlorë |

| | | | | |
|-----|--|--------------|-------------|-------------------------------------|
| | turistik | | | |
| 24. | Vlerësim i Ndikimit në Mjedis i dallgethyese, Porto Romano | Gusht 08 | G & G | Ko. Romano Port |
| 25. | Raport i Vlerësim të Ndikimit në Mjedis - VNM për zhvillim të zonës urbane fushë Prezë | Dhjetor 08 | G & G | Komuna Preze |
| 26. | Vlerësim i Ndikimit në Mjedis për TEC in Porto Romano | Shkurt 09 | G & G | Kompania RWE, ESSEN, Gjermani |
| 27. | Vlerësim i Ndikimit në Mjedis për shtrirjen e fibrave optike Lac-Rreshen | Prill 2010 | G & G | Kompania Albtelekom |
| 28. | Vlerësim i Ndikimit në Mjedis për zonën Urbane Bërçull | Qershor 2010 | G & G | Komuna Bërçull |
| 29. | Vlerësim i Ndikimit në Mjedis për Kompleks servisi ekspozitë, Vorë, Tiranë | Maj 2011 | G & G | Komuna Vorë |
| 30. | Vlerësim i Thelluar i Ndikimit në Mjedis për Kompleks rezevuarësh Mëzes, Kashar. Tiranë | Qershor 2011 | G & G | Komuna Kashar |
| 31. | Vlerësim i Ndikimit Në Mjedis i rrugës nacionale Vaqar - Elbasan | 2007 | G & G | Alba Constr. Tiranë |
| 32. | VNM të 6 HEC-eve (Menkulas, Devoll, Minas, Kuç, Braçanj) | Mars 2012 | G & G | D6 SH.P.K |
| 33. | VNM furra buke, 6 njësi, në Tiranë | 2012 | G & G | Persona fizik |
| 34. | Vlerësimi Strategjik Mjedisor i Planit Urban të Tiranës | 2012 | G & G | Bashkia Tiranë |
| 35. | Vlerësimi Strategjik Mjedisor i Planit Urban të Bubqit | Prill 2013 | G & G | Qarku Durrës |
| 36. | Vlerësimi Strategjik Mjedisor i Planit Urban të Bërzhitës | Qershor 2013 | G & G | Komuna Bërzhitë |
| 37. | Vlerësim i Ndikimit në Mjedis të shtrimit të linjave kabllore e te fibrave ne Tiranë. | Korrik 2013 | G & G group | OST, Tiranë |
| 38. | Vlerësimi Strategjik Mjedisor i Planit Urban të Komunes Rrethine Shkoder | Tetor 2013 | G & G group | Komuna Rrethine Shkoder |
| 39. | Vlerësimi Strategjik Mjedisor i Planit Urban të Komunes Novoselë Vlorë | Nëntor 2013 | G & G group | Komuna Novoselë |
| 40. | Vlerësimi Strategjik Mjedisor i Planit Urban të Bashkisë Roskovec | Janar 2014 | G & G group | Bashkia Roskovec |
| 41. | Vlerësim i Ndikimit në Mjedis për impiantin e depozitave të Gazit në Kashar, km 3, Tiranë. | Janar 2014 | G & G group | Adi Petrol, Tiranë |
| 42. | Vlerësim i Ndikimit për Servisin RED sh.p.k, Vorë | Shkurt 2014 | G & G group | “RED” shpk, Tiranë |
| 43. | Vlerësim i Ndikimit për Depozitat e Vajit, km 4 Kashar | Shkurt 2014 | G & G group | EPAgreenoil, Tiranë |
| 44. | Vlerësim i Ndikimit për Servisin dhe Lavazhin | Mars 2014 | G & G group | OST, Tiranë |
| 45. | Raport Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis , nyje raksionimi , Komuna Guri i Zi, Qarku Shkodër | Korrik 2014 | G & G group | “Mantovani” sh.p.k |
| 46. | Raport Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis ,Kompania e prodhimit të plastikave, Vorë | Tetor 2014 | G & G group | Telcom-AL |
| 47. | Raport Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis, i impiantit “Petrolgaz” të magazinimit dhe tregtimit të gazit të lëngshëm (GL), Mëzez, Komuna Kashar. | Dhjetor 2013 | G & G group | Impianti “Petrolgaz” |
| 48. | Raport Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis i kompleksit servis i makinave “RED” sh.p.k., Bashkia Vorë. | Gusht 2014 | G & G group | “RED” sh.p.k. |
| 49. | Raport Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis nga zhurmat e lokalit karaoke “Country Club” | Nëntor 2014 | G & G group | “Country Club” Tiranë, Oltion Marku |

| | | | | |
|-----|--|--------------|-------------|--|
| 50. | Raport Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis për mbledhjen e vajrave ushqimore | Shkurt 2014 | G & G group | “EPA Green Oil” |
| 51. | Raport Vlerësimi Strategjik në Mjedis, i instrumentit vendor të planifikimit të territorit | Dhjetor 2013 | G & G group | Bashkia Roskovec |
| 52. | Raport Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis, për lokalin me muzikë Live “Club Zio Nino” | Janar 2014 | G & G group | Për personin fizik “Ardit Buçpapaj” |
| 53. | Raport Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis, impianti i trajtimit të ujërave urbane Shkodër, Shirokë. | Mars 2014 | G & G group | Ndërmarrja ujsjellës kanalizime Shirokë, Shkodër |
| 54. | Monitorim lidhur me asgjësimin e mbetjeve të rrezikshme Aksi Iore. | Korrik 2014 | G & G group | “MEDI-TEL” sh.p.k. |
| 55. | Raport Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis, i depozitimit të barnave mjekësore e produkteve farmaceutike “EBIS Pharma” | Shtator 2014 | G & G group | “EBIS Pharma” sh.p.k. |
| 56. | Raport Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis, i impiantit të prodhimit të praimerit (Emulcion bituminoz) | Shtator 2014 | G & G group | “GE-CO” sh.p.k. |
| 57. | Raport Paraprak i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, për prodhimin e pllakave të betonit. | Tetor 2014 | G & G group | “K.TURJA” sh.p.k. |
| 58. | Raport Vlerësimi Paraprak i Ndikimit në Mjedis, për nyjen e Fraksionimit të Inerteve | Nëntor 2014 | G & G group | Drini-A, Bahçallëk, Shkodër. |
| 59. | Raport Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis, i impiantit të fraksionimit të inerteve Renc, Shkodër. | 2014 | G & G group | Impiant Fraksionimit, Renc, Shkodër” |
| 60. | Raport paraprak i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, për rikonstruktimin e “Hotelit Valbonë” me shtatë kate mbi tokë, Valbonë – Bajram Curri. | 2014 | G & G group | “Hotel Valbonë” |
| 61. | Raport Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis, për furnizimin me karburant të makinave, Bushat, Shkodër. | 2014 | G & G group | “Luani-A” sh.p.k. |
| 62. | Raport Paraprak i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, për linjën e ambalazhimit të ujit, (Burimi Selita & Shën Mëria) | 2014 | G & G group | Person Fizik, Agron Qoku |
| 63. | Raport Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis, të linjës së prodhimit dhe ambalazhimit të ujit Acqua Prima, (Burimi Selita) dhe të pijeve jo alkoolike | 2014 | G & G group | Kompania “Security Force – 98/Tiranë |
| 64. | Raport Paraprak i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, për godinpe shërbimi supermarket një kat mbi tokë. | 2014 | G & G group | Supermarket, “Lagjia e Re”, Komuna Ndroq. |
| 65. | Raport Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis, i Pub Uzina | Janar 2015 | G & G group | Pub “Uzina”, |



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Ministria e Ekonomisë,
Tregtisë dhe Energjetikës

LICENCË



LN-1687-06-2010
Kodi: III.2.A (1+2)
Data e lëshimit: 22/06/2010
Afati i vlefshmërisë: Pa afat

SAZAN GURI
NUJS/NIPT: K62101007P
Tirane, TIRANE, Tirane, TIRANE,
Rruga Vaso Pasha, Pallati

Emërtimi përshkrues i veprimtarisë
Veprimtaritë e ekspertizës lidhur me ndikimin në mjedis (auditim mjedisor, ndikim në mjedis).

Kod tjetër:

Kufizime specifike
Licenca ushtrohet sipas kufizimeve në legjislacionin në fuqi

Detyrime specifike
Licenca ushtrohet sipas detyrimeve në legjislacionin në fuqi

Vendi i kryerjes së veprimtarisë
Në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë

Kategoria
Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me ndikimin në mjedis

Nënkategoria
Veprimtaritë e ekspertizës lidhur me ndikimin në mjedis

Veprimtari specifike
1. Ndikim në mjedis
2. Auditim mjedisor

Specialiteti



Nënshkrimi i portelit: Andonela Heshu